

# THE KOSOVO BANKER

Dhjetor 2019 • Numër 16

## Potenciali i sektorit bankar në Kosovë: Sfidat dhe mundësitë

Industria Bankare në  
Kosovë ka hapur kapitull  
të ri për shoqërinë  
kosovare **5**

Z. Albert Lumezi

E ardhmja e sektorit  
bankar në Kosovë **7**

Dr. Sc. Fehmi Mehmeti

Intervistë me Z. Robert  
Wright, Zv. Kryetar i  
Bordit të Drejtorëve  
të SHBK-së & CEO,  
Raiffeisen Bank Kosova **10**

For a  
**debt-free  
world.**



There'll always be debt. Whether privately or in business, taking out a loan is part of life. However, if loans cannot be serviced, we use our self-learning collection software to find individual solutions for defaulting payers. By doing so, we demonstrate fair and realistic ways for achieving a debt-free life.

EOS. FOR A DEBT-FREE WORLD.



# PËRMBAJTJA

#KosovoBankingAssociation

#KosovoBankingAssociation

## 04 EDITORIAL

DR. SC. PETRIT BALIJA - KRYESHEF EKZEKUTIV -  
SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

## 05 PARATHËNIE

Industria Bankare në Kosovë ka hapur  
kapitull të ri për shoqërinë kosovare

Z. ALBERT LUMEZI  
KRYETAR I BORDIT TË DREJTORËVE TË SHBK-SË  
KRYETAR I BORDIT UDHËHEQËS TË NLB-SË

## 07 OPINION

E ardhmja e sektorit bankar në Kosovë

DR. SC. FEHMI MEHMETI - GUVERNATOR I BANKËS  
QENDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

## 10 KËNDI I INTERVISTËS

Intervistë me Z. Robert Wright, Zv.

Kryetar i Bordit të Drejtorëve të SHBK-  
së & CEO, Raiffeisen Bank Kosova

SEKTORI FINANCIAR



### 12-39

Të arriturat e sektorit bankar të Kosovës  
dhe fronti i ri - MUHARREM INAN - UDHËHEQËS  
I GRUPIT TË THESARIT DHE INSTITUCIONEVE  
FINANCIARE BANKA KOMBËTARE TREGTARE -  
KOSOVË

Ditët e lavdishme të analitikës së  
riskut në sektorin bankar - NIHAT ŞAHAY  
- MENAXHER I MODELIMIT DHE ANALIZËS SË  
RISKUT KREDITOR TEB SHA.

Sfidat dhe mundësitë e sistemit  
financiar në Kosovë në kontekstin ligjor-  
ARDIAN KADRIJAJ - DREJTOR I SHËRBIMI PËR  
PUNË JURIDIKE NLB BANK

Menaxhimi i riskut të modeleve Zhvillimi,  
validimi dhe zbatimi i modeleve -  
FATON RAMADANI - MENAXHER I RISKUT IŞBANK  
- DEGA NË KOSOVË

KËNDI I EKSPERTËVE



### 40-42

Efektet e kombinuara të përcaktuesve  
makroekonomikë dhe specifikë sipas  
bankave për NPL-të - KATERINA BOSEVSKA  
DREJTORE MENAXHUESE EOS MATRIX-  
MAQEDONI, KOSOVË



### 43-48

AKTIVITETET NGA SHBK



### 49-50

BANKAT FUQIZOJNË  
SHOQËRINË

## THE KOSOVO BANKER

KRYESHEF EKZEKUTIV I SHOQATËS SË BANKAVE TË  
KOSOVËS DHE KRYEREDAKTOR:  
Z. PETRIT BALIJA

REDAKTOR DHE ZYRTAR PËR KOMUNIKIM:  
Z. ADLUM RAMADANI

BORDI I DREJTORËVE TË SHOQATËS  
SË BANKAVE TË KOSOVËS

Z. ALBERT LUMEZI

NLB Bank / Kryetar i Bordit të SHBK-së

Z. ROBERT WRIGHT

Raiffeisen Bank / Zv. Kryetar i Bordit të SHBK-së

Z. PETRIT BALIJA

Shoqata e Bankave të Kosovës / CEO

Z. ARTON CELINA

Banka për Biznes

ZNJ. ERIOLA BIBOLLI

ProCredit Bank Kosova

Z. FATOS KRASNIQI

Banka Ekonomike

Z. MERITON SUNDURI

Ziraat Bank

Z. ORCUN OZDEMIR

TEB Bank

Z. OGUZHAN CEYLAN

IS Bank

Z. SUAT BAKKAL

Banka Kombëtare Tregtare

Banka  
Ekonomike

BKT  
BANKA KOMBËTARE TREGTARE

BPB

IŞBANK

NLB Banka

ProCredit Bank

Raiffeisen  
BANK

TEB  
THE FOREIGN BANK ASSOCIATION

ZiraatBank



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) është zëri i industrisë bankare në Republikën e Kosovës. SHBK është përfaqësuese e bankave komerciale të Kosovës, anëtare të SHBK, në lidhje me çështjet sektoriale bankare dhe bashkëpunon me të gjitha autoritetet përfshirë Kuvendin e Republikës së Kosovës, Qeverinë, Bankën Qendrore, Institucionet Financiare Ndërkombëtare, Mediat, etj, me qëllim mbështetjen e stabilitetit dhe zhvillimit të sektorit bankar në Kosovë.

The Kosovo Banker është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Botohet dy herë në vit (korrik dhe dhjetor), me qëllim të informimit të saktë të publikut lidhur me industrinë bankare në Kosovë. Shoqata e Bankave të Kosovës; Rr. Lidhja e Pejës p.n, Zona Industriale, Prishtinë; 10000. Republika e Kosovës; +381 38 246 171; www.bankassoc-kos.com; contact@bankassoc-kos.com;

# EDITORIAL



**DR. SC. PETRIT BALIJA**

KRYESHEF EKZEKUTIV - SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

Viti që po lëm pas për sektorin bankar padyshim se ishte përplot sfida por njëkohësisht solli arritje dhe suksese të shumta, të cilat edhe më tutje reflektojnë në aspiratat që ky sektor ka. Krahas progresit që arriti në rritjen e kreditimit dhe depozitave, ky vit shënoi normën më të ulët të interesit në kredi të reja në Kosovë e që paraqet mundësi të mira financuese jo vetëm të klientëve privat por njëherazi edhe të bizneseve të vogla dhe të mesme. Qëndrueshmëria e sektorit bankar përgjatë këtij viti, dëshmoi edhe njëherë potencialin për krijimin dhe ruajtjen e portfolios kreditore kualitative ndërkaq mundësoi që përmes përmirësimit të kushteve të të bërit biznes të rris konkurrencën përmes modernizimit dhe shtimit të numrit të produkteve dhe shërbimeve, të cilat padyshim mundësojnë rritjen dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të industrisë bankare në vend. Përshtatja e shërbimeve me nevojat e qytetarëve dhe bizneseve duke reflektuar në frymën bashkëkohore të zhvillimit, ka bërë që konkurrenca të zbatojë termin e arsyeshmërisë ekonomike. Kjo ka bërë që krahas shërbimeve të lehta dhe të sigurt, klienti të trajtohet dhe të adaptohet me ndryshimet të cilat ofrojnë korrektësi, shpejtësi dhe zgjidhje.

Stabiliteti i sektorit bankar pati rol të rëndësishëm edhe në zhvillimin ekonomik të vendit, duke kontribuar drejtpërdrejt në ofrimin e një qasje të gjerë financimi në shërbim të rritjes dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ndërkaq sfida kryesore krahas trajtimit të lëndëve gjyqësore të pazgjidhura, të cilat kanë bllokuar miliona euro të bankave si pasojë

e mos funksionimit të mirëfilltë të sistemit gjyqësorë në Kosovë, ishte edhe fusha e sigurisë, ku përkundër zvogëlimit të rasteve, mbetet rreziku potencial i grabitjeve të armatosura e të dhunshme i cili shqetëson edhe më tutje sektorin bankar në Kosovë. Gjithashtu, pasiguria juridike e cila shkaktohet nga nxjerrja e legjilacionit pa konsultim adekuat me sektorin bankar mbetet një burim i rreziqeve potenciale për çka Shoqata e Bankave të Kosovës angazhohet në vazhdimësi për të parandaluar duke bashkëpunuar me shumë institucione për harmonizimin e legjilacionit në mënyrë sa më të mirë.

Në kuadër të këtij edicioni, do të mësoni në hollësi me zhvillimet dhe trendet e sektorit bankar në Kosovë, ku janë trajtuar krahas potencialit edhe sfidat dhe mundësitë që e presin përpara këtë sektor. Autorët e këtij edicioni, përpos që kanë gërshtuar përvojat e tyre profesionale ata kanë arritur të japin edhe kontribut të rëndësishëm në rritjen e informacionit në lidhje me çështje kyqe të sektorit bankar si për profesionistët e sektorit financiar të Kosovës ashtu edhe për publikun e gjerë.

Ajo që e bënë këtë edicion edhe më të rëndësishëm është edhe njoftimi për publikimin e ri të Kodit të Praktikës Bankare nga Shoqata e Bankave të Kosovës. Ky Kod paraqet një përkushtim dhe ri-afirmim të vlerave dhe etikës biznesore të anëtarëve të Shoqatës së Bankave të Kosovës. Një kopje e këtij kodi do të jetë në dispozicion për shkarkim nga webfaqja zyrtare e ShBK-së. Urime festat e fundvitit dhe një vit të ri sa më të mbarë!





**ALBERT LUMEZI**

Kryetar i Bordit të Drejtorëve të SHBK-së

Kryetar i Bordit Udhëheqës të NLB-së

# Industria Bankare në Kosovë ka hapur kapitull të ri për shoqërinë kosovare

**K**rahas potencialit në rritje për mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit, e njëjta ka arritur t'u shërbejnë qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës duke ofruar një gamë të gjerë të shërbimeve financiare. Konsolidimi i sektorit bankar në bashkëveprim me rregullatorin, Bankën Qendrore të Kosovës, ka prodhuar një frymë të re, duke kontribuar pozitivisht në ambientin e të bërit biznes dhe duke hapur mundësi të reja, të cilat drejtpërsëdrejti i shërbejnë klientelës së sektorit bankar dhe jo vetëm. Kontributi i vazhdueshëm përmes përgjegjësisë për komunitetin (CSR) gjithashtu ka luajtur rol të rëndësishëm në përkrahjen e aktiviteteve të ndryshme shoqërore, përmes së cilave, jo vetëm që janë promovuar kauza të ndryshme por njëkohësisht janë krijuar ura të reja të bashkëpunimit për një shoqëri të shëndosh.

Qëndrueshmëria e sektorit bankar në Kosovë dhe kontributi i drejtpërdrejtë i BQK-së për t'i siguruar vendit një sistem financiar stabil dhe në funksion të zhvillimit ekonomik, ka bërë që industria bankare të jetë ndër shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit. Sot, në Republikën e Kosovës operojnë 10 (dhjetë) banka komerciale dhe përbëjnë 66.14 përqind të aseteve totale të sektorit financiar ndërkaq totali i kredive është 2.755.5 milion euro.

Zhvillimi i sektorit bankar ndër vite, ka bërë që kërkesat për kredi të rriten, numri i depozitave po ashtu ka shënuar rritje të vazhdueshme, ndërkaq kreditë jo-performuese kanë shënuar rënie graduale duke u përcjell edhe me ulje të interesit. Krijimi i

kornizave rregullative së bashku me gatishmërinë e bankave për të krijuar infrastrukturë të re operuese ka bërë që ky sektor mjaft i rëndësishëm t'a ruaj stabilitetin në treg. Krahas funksionimit efikas që ka arritur t'a dëshmojë industria bankare, e njëjta brenda një periudhe të shkurtë kohore ka arritur të implementojë korniza ndërkombëtare të standardizimit, të modernizojë shërbimet bankare dhe të ofrojë produkte mjaft tërheqëse dhe inovative, duke krijuar mundësi të reja të përmirësimit të ambientit të përgjithshëm afarist në vend dhe rritjen e konkurrencës.

Në anën tjetër, industria bankare vazhdon të sfidohet në disa aspekte. Tash e thajse dy dekada, bankat vazhdojnë të ballafaqohen me lëndët gjyqësore të pazgjdhura nga sistemi i drejtësisë në Kosovë, ku deri në vitin 2017, gjithësejt numri i lëndëve ka kapur shifrën prej 7831 raste, përkthyer në vlerë prej 150,367,847.72 EUR. Ky fakt është sa shqetësues aq edhe sfidues për t'u zgjidhur, pasi që kërkon angazhim intensiv nga institucionet e drejtësisë në mënyrë që çështja të përmbyllet brenda një cikli të shpejtë kohor. Themelimi i një gjykate komerciale është më se e nevojshme për të adresuar këtë problem me efikasitet dhe në aspekt afatgjatë. Shoqata e Bankave të Kosovës angazhohet për të promovuar një zhvillim të tillë i cili do të ishte shumë pozitiv për të realizuar më mirë potencialet e sektorit financiar. Krahas kësaj, janë rikuperimi i kredive jo-performuese që vazhdojnë të mbesin sfidë ani pse si statistikë, normat e kredive jo-performuese janë



ndër më të ulëta në rajon ndërkaq përmirësimi i mëtejshëm i portofolit të kredive të këqija padyshim që është ndër objektivat parësore të sektorit bankar në Kosovë. Risqet e ekspozimit ndaj sulmeve fizike mbetet akoma si shqetësim megjithëse ka pasur përmirësime të mëdha nga ana e institucioneve të sigurisë në Kosovë të cilat kanë shtuar masat e sigurisë dhe angazhimin e tyre për të sjellë grabitësit e bankave para drejtësisë duke arrestuar një numër të konsiderueshëm të tyre gjatë vitit që lamë pas. Kjo fal edhe bashkëpunimit që është krijuar me nënshkrimin e marrëveshjes së sigurisë në mes të Shoqatës së Bankave, Policisë së Kosovës, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Bankës Qendrore të Kosovës. Sektori bankar vazhdon të investoj në sigurinë kibernetike që është po aq sfiduese



Qëndrueshmëria e sektorit bankar në Kosovë dhe kontributi i drejtpërdrejtë i BQK-së për t'i siguruar vendit një sistem financiar stabil dhe në funksion të zhvillimit ekonomik, ka bërë që industria bankare të jetë ndër shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit. Sot, në Republikën e Kosovës operojnë 10 (dhjetë) banka komerciale dhe përbëjnë 66.14 përqind të aseteve totale të sektorit financiar ndërkaq totali i kredive është 2.755.5 milion euro.

për sektorin bankar, në veçanti tash kur digitalizimi i shërbimeve bankare ka marrë një dinamikë të mirë në Kosovë. Bankat kanë arritur me sukses që të vendosin parametra të sigurisë kibernetike duke ofruar shumë shërbime digjitale për pagesa dhe transfere të cilat edhe janë kërkesë bashkëkohore e klientëve bankar. Në përfundim, mund të them se sektori bankar i Kosovës ka dhënë një kontribut të madh në zhvillimin ekonomik të Kosovës deri më tani por potenciali i saj mbetet ende i pa realizuar plotësisht dhe ne besojmë që me adresimin e çështjeve të cekura më lartë si dhe shumë çështjeve tjera që janë trajtuar në këtë edicion të revistës The Kosovo Banker, ne mund ta realizojmë atë potencial në dobi të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.



**DR. SC. FEHMI MEHMETI**  
Guvernator i Bankës Qendrore  
të Republikës së Kosovës

## E ardhmja e sektorit bankar në Kosovë

Sektori Bankar i Kosovës është një nga tregimet kryesore të suksesit të zhvillimit ekonomik në dy dekadat e fundit. Ky sektor përgjatë këtyre dy dekadave, e posaçërisht në fillimet e tij, ka kaluar sfida të ndryshme si mungesa e ligjeve dhe rregulloreve, mungesa e kapaciteteve njerëzore, nivel i ulët i edukimit financiar, ambienti i pasigurt politik, si dhe mungesa e infrastrukturës mbështetëse. Të gjitha këto sfida sektori bankar i ka kaluar me sukses dhe tanimë ka zhvilluar kapacitetet e nevojshme për t'u ballafaquar me sfidat në dekadën e ardhshme siç janë integrimi i mëtutjeshëm i sektorit bankar të Kosovës me sektorët e vendeve të zhvilluara, adaptimi ndaj zhvillimeve shumë dinamike të teknologjisë informative të cilat shpien në inovacion në fushën e digjitalizimit të shërbimeve financiare, përdorimin e volumit të madh të të dhënave dhe në përgjithësi përshatjen në një ambient ekonomik, i cili mbështetet më shumë në teknologjinë informative.

Fakti që sfidat me të cilat ballafaqohet sot sektori bankar i Kosovës janë të ngjashme me sfidat me të cilat karakterizohen bankat e vendeve të zhvilluara argumenton suksesin e deritanishëm të këtij sektori, i cili ka arritur një fazë të kënaqshme të pjekurisë. E gjithë kjo është arritur në një kohë të shkurtër. Sot ky sektor në aspektin e shëndetit financiar mbetet një nga më të mirët në rajon por edhe më gjerë, me tregues të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 16.7%, kthim në kapital prej 15.8% dhe kredi joperformuese prej 2.4%, e cila është norma më e ulët në mesin e të gjitha vendeve të rajonit.



Bankat në Kosovë kanë një potencial të lartë financiar, kapacitete të avancuara operacionale dhe menaxheriale dhe në të njëjtën kohë, te bankat e huaja vërehet edhe një mbështetje e madhe nga zyrat e tyre qendrore.



Fakti që sfidat me të cilat ballafaqohet sot sektori bankar i Kosovës janë të ngjashme me sfidat me të cilat karakterizohen bankat e vendeve të zhvilluara argumenton suksesin e deritanishëm të këtij sektori, i cili ka arritur një fazë të kënaqshme të pjekurisë. E gjithë kjo është arritur në një kohë të shkurtër.

**SOT KY SEKTOR NË ASPEKTIN E SHËNDETIT FINANCIAR MBETET NJË NGA MË TË MIRËT NË RAJON POR EDHE MË GJERË, ME TREGUES TË MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT PREJ**

**16.7%**  
kthim në kapital

**prej 15.8%**  
dhe kredi joperformuese

**prej 2.4%**

e cila është norma më e ulët në mesin e të gjitha vendeve të rajonit.



Bankat në Kosovë kanë një potencial të lartë financiar, kapacitete të avancuara operationale dhe menaxheriale dhe në të njëjtën kohë, te bankat e huaja vërehet edhe një mbështetje e madhe nga zyrat e tyre qendrore. Këto kushte i kanë ndihmuar bankave për të identifikuar shumë herët sfidat dhe mundësitë e tyre, duke mundësuar kështu një zhvillim të suksesshëm të afarizmit të tyre. Kapacitetet njerëzore janë rritur si për nga kualiteti, ashtu edhe për nga kuantiteti. Kapacitetet operationale janë zhvilluar dhe janë bërë shumë më efikase. Menaxhimi i bankave është përmirësuar vazhdimisht dhe kjo dëshmohet edhe nga rezultatet e arritura. Në të njëjtën kohë, situata ekonomike dhe politike e Kosovës është përmirësuar duke krijuar kushte më të mira për zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit financiar. Mbetet sfida çështja e sigurisë nga aktivitetet kriminale duke përfshirë ato kibernetike. Digjitalizimi i vazhdueshëm na ekspozon edhe më shumë ndaj këtij rreziku, i cili ka një natyrë vazhdimisht të ndryshueshme dhe një kosto vazhdimisht në rritje. Sipas disa studimeve kostoja shtesë e krimeve kibernetike për kompanitë në nivel global mund të





tejkalojë vlerën prej \$5 miliardë në 5 vitet e ardhshme. Bashkëpunimi ndërinstitucional është i domosdoshëm për luftimin e krimit kibernetik. Rritja e proteksionizmit tregtar në nivel botëror, mund të dëmtojë ekonominë globale dhe zhvillimin ekonomik të të gjithëve duke ndikuar në rënien e investimeve. Këto zhvillime negative padyshim që do të ndihen edhe në Kosovë pasi që ende ka nevojë për investitorë të huaj.

Përkundër sfidave të përmendura më sipër, sektori bankar në të njëjtën kohë ka shumë mundësi që mund të shfrytëzohen në të ardhmen. Digjitalizimi përkundër rrezikut që ka, sjellë mundësi të shumta dhe në mes të tjerash do të përshpejtojë integrimin në sistemin bankar të Bashkimit Evropian. Përmirësimi i shkallës së edukimit financiar në Kosovë do t'iu mundësojë bankave, që të rrisin gamën e gjerë të produkteve të tyre si këshillim financiar, financim në ekuitet, menaxhim të aseteve dhe shërbimet e ruajtjes së letrave me vlerë, si dhe rritjen e tregtimit të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës në tregun sekondar. Rritja e gamës së shërbimeve do të mundësojë edhe diversifikim të të hyrave por edhe ekonomi të shkallës, duke e përmirësuar edhe më shumë eficiencën e bankave. Tregu i kredive hipo-

tekare paraqet një mundësi të rritjes gjithashtu, pasi ky treg mbetet dukshëm më pak i zhvilluar. Ekonomia joformale në Kosovë mbetet e lartë përkundër rënies që ka shënuar ndër vite. Zvogëlimi i ekonomisë joformale është gjithashtu një mundësi e mirë për rritje të sistemit bankar. E njëjta mundësi ekziston edhe në qasjen në financa e cila tashmë është përmirësuar me paraqitjen e Fondit Kosovar për Garanci e Kreditore. Ky fond ka ende potencial të cilin besoj që bankat do ta shfrytëzojnë për rritjen e qasjes në financa.

Duke pasur parasysh resurset aktuale të bankave qofshin financiare, të kapitalit fizik dhe atij njerëzor, besoj që bankat me sukses do t'i kalojnë sfidat në të ardhmen dhe në të njëjtën kohë do t'i shfrytëzojnë mundësitë e shumta që i kanë për zhvillim më mëtutjeshëm në shumë dimensione dhe do të vazhdojnë të përkrahin ekonominë e Kosovës, si dhe të rrisin kreditimin në raport me Bruto Prodhimin Vendor.

BQK-ja do të mbetet partner i këtij sektori duke iu siguruar ambient të përshtatshëm rregullativ dhe konkurrencë të drejtë në arritjen e objektivit të saj për të nxitur dhe për të mbajtur një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave.

**ROBERT WRIGHT**

Zëvendës Kryetar i Bordit të Drejtorëve, Shoqata e Bankave të Kosovës  
& CEO, Raiffeisen Bank Kosova

# Intervistë: Gjendja aktuale në sektorin bankar të Kosovës

## SI E SHIHNI PERFORMANCËN AKTUALE TË SEKTORIT BANKAR NË KOSOVË?

Performanca e tashme e sektorit bankar të Kosovës është shumë pozitive dhe kam besim se do t'i kemi disa nga treguesit më të mirë kryesorë të performancës në fund të këtij viti. Rezultatet e tremujorit të tretë të vitit 2019 janë shumë të favorshme dhe disa nga krahasimet nga viti në vit janë më të mirat në rajon. Për shembull, rritja e kredisë nga viti në vit për individët privat ishte 10.1% krahasuar me 5% në Shqipëri dhe 9.7% në Maqedoninë e Veriut. Kreditë jo-performuese janë më të ulëta në rajon me 2.2% dhe profiti i sektorit bankar të Kosovës u rrit me 9.3% në krahasim me TM3 2018. Industria bankare është një shembull i shkëlqyeshëm i investimit të suksesshëm direkt të huaj në Kosovë dhe ky është një faktor kyç në vendimin e Bankës Credins në Shqipëri për t'i filluar operimet këtu.

## CILAT JANË SFIDAT KRYESORE TË SEKTORIT BANKAR QË JANË EVIDENTE GJATË VITIT QË E LAMË PRAPA?

Mendoj se ishin 2 sfida kyçe për sektorin bankar në vitin 2019. Sfida e parë ishte mungesa e përparimit me zhvillimin e një rrjeti ATM dhe PoS të kombinuar, efikas dhe miqësor për klientë. Kompleksiteti aktual, kostoja dhe konfuzioni i klientit ka nevojë për vëmendje urgjente. Asociacioni i Bankave dhe palët tjera relevante do t'i japin kësaj prioritet të lartë në vitin 2020. Sfida e dytë në vitin 2019 vazhdoi të jetë rikuperimi dhe zgjidhja e kredive delikuede. Edhe pse kreditë jo-performuese kanë rënë dukshëm nga 8.7% në 2013 në 2.2%, sot ka ende mijëra raste të pazgjidhura, ku disa janë më të vjetra se 10 vjet.

## A MENDONI SE KA PASUR PËRMIRËSIM NË MJEDISIN E TË BËRIT BIZNES NË KOSOVË?

Mendoj se është e rëndësishme që t'i përgjigjem kësaj pyetje bazuar në statistika të pavarura të besueshme, e jo nga një këndvështrim i ngushtë subjektiv. Një burim i tillë i të dhënave të besueshme është Raporti 'Të Bërit Biznes' i Bankës Botërore dhe nga tetori 2018 deri në tetor 2019 ka pasur ndryshime të vogla dhe rezultate shumë pozitive për marrjen e kredisë në Kosovë - shteti renditet në vendin 15 në vitin 2019 krahasuar me vendin 12 në vitin 2018; përmbarimi i kontratave është përmirësuar, nga vendi 49 në vitin 2018, në vendin 53 në vitin 2019

## SIPAS MENDIMIT TUAJ, ÇKA DUHET TË PRITET NË VITIN 2020 NË KUPTIM TË ZHVILLIMIT TË MËTUTJESHËM TË SEKTORIT BANKAR NË KOSOVË?

Në vitin 2020 industria do ta vazhdojë kalimin në funksionim digjital pasi nevojat e klientëve vazhdojnë të ndryshojnë dhe rregullimi dhe teknologjia e informacionit vazhdojnë ta lehtësojnë ndryshimin. Sidoqoftë, dua të theksoj, edhe pse formati i degës bankare mund të ndryshojë me kalimin e kohës, prapëseprapë do të ekzistojë një rrjet i konsiderueshëm i degëve në tërë Kosovën për t'i përballuar nevojat bankare dhe aktivitetet e menaxhimit të marrëdhënieve. Besoj se do ta kemi një vit tjetër të rritjes së shkëlqyeshme të kredive dhe se do të arrihet përparim i rëndësishëm në 2 fusha kryesore - para së gjithash, çështja që e përmenda më parë - koordinimi i shtuar dhe lehtësimi i rrjeteve tona PoS dhe ATM, dhe së dyti, qasja e shtuar në financa në bazë më të gjerë të klientelës pasi industria bankare vazhdon të rritet dhe të zgjerohet si rezultat i performancës së saj shumë të suksesshme.



Shkarko Kodin e Praktikës Bankare në [www.bankassoc-kos.com](http://www.bankassoc-kos.com)

**MUHARREM INAN**


Udhëheqës i Grupit të Thesarit dhe  
Institucioneve Financiare  
Banka Kombëtare Tregtare - Kosovë

## Të arriturat e sektorit bankar të Kosovës dhe fronti i ri

**V**endi i Newborn-it ka ekonomi dhe demografi dinamike. Gjatë dekadës së fundit, ekonomia e Kosovës ka mbajtur ritëm krahasimisht të lartë të rritjes në rajon, i cili është shprehur me rritje ekonomike prej mbi 4% në vit që nga 2015. Me moshën mesatare në vend rreth 26 vjeç, që është më e reja në Evropë, dhe pothuajse një të tretën e popullsisë nën 30 vjeç, fryma e re e Kosovës ushqen dinamizmin e vendit dhe rrjedhimisht Kosova radhitet në vendin e 44-të në raportin Të Bërit Biznes të Bankës Botërore. Ndikimi i sektorit bankar në rritjen e vendit ka qenë i ndjeshëm. Sektori bankar i Kosovës ka qenë motori shtytës prapa kësaj shkalle të qëndrueshme të rritjes në vend ku totali i huave arrin në pothuajse 40% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) për ekonominë.

Në këtë drejtim, shkalla stabile dhe e lartë e rritjes në krahasim me rajonin ka ndikuar pozitivisht në sektorin bankar në Kosovë, që jep tregues të mirë për strukturën e shpërblimit të riskut, që do të thotë se kreditë e dhëna për ekonominë pasqyrohen si rritje në ekonominë reale.

Këto dinamika mund të vërehen edhe në financat e bankave. Sektori bankar i Kosovës është i kapitalizuar mirë dhe fitimprurës me raport të mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) rreth 18%, kthim nga aktivet mbi 2.00% dhe kthimi nga ekuiteti mbi 20%. Ekzistenca e bankave ndërkombëtare në sektor vërteton atraktivitetin e vendit dhe lehtësinë e të bërit biznes në vend. Shkalla më e ulët për NPL në rajon paraqet edhe një tregues tjetër të mirë të sektorit financiar të shëndoshtë



dhe stabil. Përveç kësaj, raporti më i ulët në rajon borxh-PBB me 17% konfirmon që, sipas nevojës, qeveria mund ta mbështesë ekonominë përmes politikës fiskale.

Në vitet e fundit, sektori bankar është përqendruar në dixhitalizimin dhe efikasitetin operacional. Në këtë drejtim, përshtatja me trendet ndërkombëtare në Kosovë ka qenë e shpejtë dhe me kohë. Dixhitalizimi në sektorin bankar ndihmon në

uljen e kostove operacionale dhe uljen e riskut, ndërkohë që e bën vendin qendër të mundshme për zhvillimin e produkteve të teknologjisë financiare (fin-tech). Popullsia dinamike dhe e re e vendit mund të jetë avantazh për sektorin bankar, si dhe për shndërrimin e bankave konvencionale në banka me fin-tech. Në Kosovë, njerëzit janë familjarizuar me bankat dhe janë entuziastë për t'i përdorur produktet bankare, ndërsa kjo mbështetet nga bankat me rrjete të mëdha prej më shumë se 200 degëve në të gjithë vendin. Në këtë drejtim, duke pasur parasysh nivelin e lartë të njohurive financiare, potenciali për të zhvilluar produkte të reja për qëllime diversifikimi është shumë i lartë. Për të ilustruar, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), synon të fillojë transaksionet e riblerjes (repo) me bankat. Kjo do t'i bëjë bonot e thesarit dhe obligacionet më tërheqëse për investime ndërsa i ndihmon bankat që të administrojnë më mirë likuiditetin. Ndërmarrja e hapave pioniere nga BQK në sektorin bankar ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit bankar në përgjithësi.

Ekonomia e Kosovës varet shumë nga remitencat e diasporës që përbëjnë 13% të PBB, që arrijnë deri në EUR 800 milionë përmes kanaleve zyrtare ndërsa ka edhe fluks hyrës përmes mjeteve të tjera. Në funksion të kësaj, ekziston nevoja për të analizuar vendet e tjera që kanë pasur të njëjtin model të ekonomisë në të kaluarën për të caktuar diagnozën e saktë dhe për t'u përgatitur për largimin e remitencave nga trendet e zakonshme. Meqenëse pjesa më e madhe e diasporës jeton në Gjermani dhe Zvicër, ekonomia e Kosovës është e ndikuar nga situata ekonomike në Evropë ku normat negative të interesit aplikohen për t'i dhënë hov ekonomisë. Ndërsa popullsia e re paraqet shans për vendin, Kosova po përballet me ikjen e trurit në drejtim të vendeve të zhvilluara. Së këndejmi, bashkëpunimi i ngushtë midis bankave, korporatave dhe universiteteve është thelbësor për të ulur dhe kontrolluar ritmin e këtij fluksi.

Kërcënimi më i madh për sektorin bankar është ulja e shkallës së rritjes së depozitave. Në 8 vitet e fundit, depozitat janë rritur mesatarisht me 7.00%, megjithatë rritja është



### ZHVILLIMET E FUNDIT NË SEKTORIN BANKAR DO T'I SHTYJNË BANKAT TË GJEJNË ALTERNATIVA TË REJA;

- për gjenerimin e të ardhurave,
- për burime të financimit me kosto më të ulët,
- për menaxhimin e riskut, së bashku me më shumë përqendrim në dixhitalizimin dhe efikasitetin operacional.

treguar të jetë shumë e përqendruar. Përkundër shkallës së dobët të rritjes në anën e depozitave, konkurrenca në sektorin bankar për rritje në madhësinë e pjesës së aktiveve ka qenë e ashpër, e shoqëruar me pritjet për hyrje të aktorëve të rinj. Struktura ekzistuese e tregut do të vazhdojë të nxisë rritjen e kostonë së financimit, ndërsa shkalla e huadhënies ka shënuar trend në rënie ndër vite, duke rezultuar në marzhë të interesit neto (NIM) më të ulët për sektorin bankar. Në kushte të tilla, bankave do t'u duhet të përqendrohen në punë ndërkombëtare bankare në mënyrë që të diversifikojnë burimet e tyre të financimit dhe të hapin rrugën për fondet ndërkombëtare. Nga ana tjetër, me NIM në rënie dhe zgjerim të maturimit të kredive në sektor, bankat do të duhet të përqendrohen më shumë në menaxhimin e riskut të normës së interesit. Në këtë drejtim, Menaxhimi i Aktiveve dhe Pasiveve (ALM) do të jetë çështje kritike për sektorin bankar në vitet në vijim. Gjithashtu, me mbikëqyrjen e BQK, aktorët në sektorin bankar duhet të krijojnë infrastrukturë për transaksione derivative për t'u mbrojtur nga risku i normës së interesit në bilancet e gjendjes.

**NIHAT ŞAHAY**

Menaxher i Modelimit dhe Analizës  
së Riskut Kreditor  
TEB Sh.A.

## Ditët e lavdishme të analitikës së riskut në sektorin bankar

Si vendi i dytë më i ri i botës dhe vendi më i ri i Evropës, Republika e Kosovës dhe populli i saj janë të vendosur të zënë hapin me pjesën tjetër të Ballkanit Perëndimor dhe Evropës ndërsa po gëzojnë pavarësinë pas një historie me trazira dhe luftë të hidhur. Përkundër sfidave të mëdha në shtetformim dhe ekonomi, vendi po ecën përpara për të hapur dyert për investitorët dhe për të ofruar mundësi ku nuk përjashtohen shërbimet financiare. Ekzistojnë disa aktorë vendorë dhe ndërkombëtarë në industrinë bankare dhe popullsia e Kosovës është ndër më të rejat në Evropë me moshë mesatare prej 28 vjeç që ofron avantazh të jashtëzakonshëm në shërbimet bankare për individë. Shkalla më e lartë e përdorimit të internetit në rajon e krahasueshme me vendet kryesore të Evropës Perëndimore, rinia dhe krahu i punës relativisht i kualifikuar, stabiliteti i përdorimit të euros si valutë, remitencat e diasporës, tendenca për martesë në moshat e hershme duke gjeneruar kërkesë të madhe për banim dhe shpenzime, rritja e madhe ekonomike dhe nivelet e ulëta të NPL janë përparësi për shërbimet bankare për individë në Kosovë, duke ua bërë të mundur huadhënësve të shënojnë rritje dyshifrore të kreditimit. Nga ana tjetër, shkalla e lartë e papunësisë, fuqia e ulët blerëse, ekonomia e orientuar drejt importit që nënkupton deficit të vazhdueshëm tregtar, ekonomia joformale dhe mungesa e transparencës fiskale, pagesa e rrogave në para të gatshme, çështjet infrastrukturore dhe mjedisore paraqesin sfida të



Ndërsa bota e shërbimeve bankare për individë po kalon nëpër një revolucion dixhital, sektori bankar i Kosovës po punon për të kapur hapin me trendet e fundit dhe për të mbyllur hendekun.

mëdha për vendin e ri. Shërbimet bankare për individë janë shërbim i tregut masiv që kurrë nuk ka qenë më dinamik, duke pasur axhendë të vështirë me mundësi interesante. Në shumë tregje, bankat janë nën presion ekonomik dhe po orvaten të përmirësojnë produktet dhe shërbimet e tyre përmes dixhitalizimit. Individët kërkojnë shërbime të shpejta, të thjeshta dhe të lehta ndërsa bankat përballen me konkurrencë të lartë, kosto dhe rregullore. Shërbimet bankare për individë ofrojnë dy shërbime thelbësore për klientët; kursime dhe hua. Investimet e transformimit dixhital të bankave për këto shërbime themelore po e shtojnë analitikën e avancuar si faktorin kryesor që kontribuon në formimin e axhendës strategjike nga udhëheqësit dhe analitika e riskut po hyn në një epokë të artë me kërkesë dhe ofertë masive për kredi përmes çdo kanali të mundshëm.

Ne jemi dëshmitarë të një prej periudhave të përparimit të historisë njerëzore. Që prej disa dekadash, mijëvjeçari i ri është emëruar si epoka e informacionit, epoka e kompjuterëve ose epoka dixhitale. Bizneset kanë filluar të kuptojnë vlerën e të dhënave dhe informacionit, ashtu sikur edhe bankat kanë vërejtur thesarin e vërtetë që ata posedojnë. Me disponueshmërinë e informacionit, përparimet në teknologji dhe teknikat e reja analitike, bankat mund të zbulojnë strategji më të thella dhe më të sakta. Fuqia e analitikës së avancuar si metodologji e vërtetë e biznesit është në përdorim të gjerë kur bankat janë ambicioze për ta rritur




Popullsia e Kosovës është ndër më të rejat në Evropë me moshë mesatare prej



# 28 vjeç

**që ofron avantazh të jashtëzakonshëm në shërbimet bankare për individë**



portofolin e tyre në një mjedis tejet konkurrues ndërkohë që luftojnë për t'i dalë ndesh pritjeve të larta të klientëve për shërbime të shpejta dhe të thjeshta financiare. Shfrytëzimi i analitikës mundëson që bankat të gjejnë burime të reja të rritjes dhe të vërejnë mundësi të tëra, të rrisin produktivitetin dhe përvojën e klientit, të përshpejtojnë proceset e vendimmarrjes dhe të forcojnë kontrollat e riskut.

Ekipet për Biznes dhe Risk po përpilojnë/përvetësojnë teknika dhe modele të reja analitike për t'i angazhuar dhe përqaftuar të gjitha potencialet në dispozicion. Ekipet e riskut tashmë kanë përdorur analitikën për një kohë të gjatë, por epoka e informacionit i ka dhënë hov ekspertizës së tyre e cila mund t'i mbës-



**Në shumë tregje, bankat janë nën presion ekonomik dhe po orvaten të përmirësojnë produktet dhe shërbimet e tyre përmes dixhitalizimit.**

htesë udhëheqësit në formimin e strategjive kryesore të bankës. Në ditët e sotme, disa aktorë të mëdhenj në sektorin e teknologjisë financiare tashmë kanë filluar të ndërtojnë modele komplekse biznesi dhe risku duke përdorur inteligjencën artificiale dhe makinerinë nxënëse. Disa kompani analitike janë duke zhvilluar modele të riskut kreditor duke përdorur makinerinë nxënëse me algoritme mahnitëse në vend të fletënotimeve klasike. Konceptet e biznesit po evoluojnë me ritëm kaq të pasiq që tashmë ka krijuar ekosistem masiv financiar. Bankat mund të përfitojnë të hyra më të larta dhe produktivitet me më pak risk duke shtytur modele të avancuara analitike të kreditimit. Vendimmarrja e shpejtë

dhe e njëtrajtshme duke përdorur modelet e riskut është shtrirë në të gjithë financimin e konsumit nga disa huadhënës që kanë ndikim në tregjet automobilistike dhe hipotekare, madje edhe në disa financime të biznesit të vogël. Jo vetëm sigurimi kreditor, por edhe aktivitetet e tjera bankare bëhen të mundura me analitikën e avancuar të riskut. Nga ana tjetër, ka shumë barrierë që i pengojnë huadhënësit që t'i realizojnë përfitimet e mundshme të analitikës së riskut, siç janë: izolimi i analitikës nga procesi i krijimit të strategjisë së biznesit, infrastruktura

e pamjaftueshme e teknologjisë dhe e të dhënave, faktorët organizativë dhe të kompetencave, kufizimet rregullatore dhe të kostos.

Bankat në Kosovë punojnë shumë për ta kthyer të gjithë potencialin në shanse të mëdha. Ndonëse disa udhëheqës sot e konsiderojnë vetëm aspekt anësor për bizneset kryesore, analitika e avancuar është motor i revolucionit në industrinë bankare që do të godasë konkurrencën dhe do të krijojë pionierë të llojit të vet.

**Ndërsa bota e shërbimeve bankare për individë po kalon nëpër një revolucion dixhital, sektori bankar i Kosovës po punon për të kapur hapin me trendet e fundit dhe për të mbyllur hendekun.**

**Ja disa rekomandime për të kontribuar në zhvillimin e industrisë dhe për të kapur shanset në Kosovë duke përdorur analitikën e avancuar:**

- **Të imponohet analitika e avancuar për të gjitha proceset e vendimmarrjes;**
- **Të pranohet vlera e analizës së riskut dhe të futet në axhendën kryesore strategjike;**
- **Të formohet struktura organizative me ekipe të pavarura dhe të kualifikuara të analitikës, të veçohet analitika e riskut nga funksionet tjera;**
- **Të përpunohen të gjitha të dhënat e brendshme të cilat janë të disponueshme dhe të shëndosha, të konsiderohet si opsion eksternalizimi i shërbimeve për ekspertizë analitike;**
- **Bashkëpunimi ndër-kolegjal për të marrë të dhëna të jashtme më të vlefshme: Tashmë është krijuar një nivel i caktuar për mbledhjen e të dhënave të jashtme me rëndësi thelbësore për vendimmarrje por rekomandimet mund të radhiten si vijon:**
  - Regjistri i Kredive të Kosovës (RKK) është bazë e të dhënave në nivel institucional (nivel byroje) me rëndësi thelbësore për huadhënësit. Unë do të rekomandoja që ta ketë modelin e vet të riskut që gjeneron Notë Kreditore (e byrosë) për secilin klient që aplikon për kredi
  - RKK mund të shndërrohet në një Platformë Risku të atypëratyshme, ku individët do të mund ta blejnë historinë kreditore të tyre për përdorim në jetën shoqërore, si për shembull kur duan të marrin me qira ndonjë pronë/automjet ose kur kërkohet ndonjë referencë tjetër
  - Mund të ofrohen disa shërbime konsulence nga byroja ose huadhënësit në mënyrë që të rritet niveli i njohurive financiare të njerëzve për huadhënien me përgjegjësi dhe për mirëqenien e sistemit.
  - Çdo e dhënë tjetër historike e detyrimeve të klientit, si pagesa e faturave të shërbimeve komunale, mund të raportohet përmes bazave të të dhënave të reja që do të krijohen
  - Huadhënësit do të jenë në gjendje të verifikojnë aplikantët përmes bazës së të dhënave të Trustit (Trusti i Kursimeve Pensionale i Kosovës) nëse ata janë të punësuar në të vërtetë dhe a kanë histori punësimi, duke i bërë të mundur kontrollin e mashtrimit dhe besueshmërisë
  - Mund të krijohet baza e automatizuar e të dhënave nga Agjencia e Regjistrimit të Biznesit në Kosovë (ARBK) për të verifikuar kompaninë e aplikantit të punësuar/ në partneritet





### ARGJIRA KADRIJAJ DUSHI

Udhëheqëse e Funkcionit për  
Zhvillim Biznesi  
ProCredit Bank Kosova

## Potenciali dhe sfidat në financimin e sektorëve strategjik të biznesit

Sot Kosova ka një sektor modern dhe të qëndrueshëm bankar që ofron funksionet e një sistemi bankar evropian dhe luan rol kyc në zhvillimin e bizneseve si dhe në rritjen ekonomike. Në këtë aspekt, rol kyc i bankave në përgjithësi është ofrimi i shërbimeve financiare tek ndërmarrjet duke ndihmuar në rritjen e kapitalit të tyre që është e domosdoshme për zhvillim ekonomik, dhe duke siguruar stabilitet ekonomik dhe social. Ndër të tjera sektori bankar në Kosovë ofron sisteme digjitale, moderne dhe efikase të pagesave, të domosdoshme për kryerjen e transaksioneve ditore nga ana e bizneseve, kanalizon burimet financiare prej depozituesve fillestare në projekte investuese dhe ndërmarrje dhe ofron një gamë të gjerë të shërbimeve elektronike dhe produkteve financiare përfshirë financimin e tregtisë.

Duke marrë parasysh ndikimin në zhvillim ekonomik, në fokus të bankave në Kosovë, në veçanti fokus i bankës ProCredit mbesin ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. NVM-të janë shtylla e ekonomisë evropiane. Këto ndërmarrje promovojnë rritje ekonomike të qëndrueshme, rrisin inovacionin, promovojnë industrializim të qëndrueshëm dhe mbi të gjitha ndikojnë në rritje të punësimit. NVM-të përfaqësojnë 99% të të gjitha bizneseve në EU dhe në pesë vitet e fundit ato kanë krijuar rreth 85%



të vendeve të reja të punës<sup>1</sup>. Sipas burimeve të ndryshme të Komisionit Evropian, përfaqësojnë rreth 45% të të gjithë të punësuarve në shtetet e zhvilluara dhe në shtetet me ekonomi në zhvillim e sipër si Kosova, këto ndërmarrje parashihet që përfaqësojnë rreth 90% të të punësuarve. Aftësia e NVM për t'u rritur varet shumë nga potenciali i tyre për të investuar, në rritje e zhvillim si dhe në inovacion dhe kualifikim. Të gjitha këto investime kanë nevojë për kapital dhe rrjedhimisht për qasje në financa. Në Kosovë, burim kryesor financiar për

bizneset vazhdojnë të mbeten kreditë nga bankat komerciale.

Në vitin e fundit, bankat kanë lehtësuar ofertën kreditore për NVM-të me lehtësimin e standardeve të kredidhënies dhe kjo vërehet përmes përmirësimit të kushteve të financimit dhe rritjes së kërkesës së mirëfilltë për financim. Pra, politika më e lehtësuar kredituese e bankave në këtë vit është realizuar kryesisht përmes uljes së normave mesatare të interesit, ofrimit të kredive me afat më të gjatë maturimi dhe rritjes së shumës së kredisë.

<sup>1</sup> Raport nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin



## SEKTORI BANKAR

PRODHIMI  
**32%**

BUJQËSIA  
**4%**

NDËRTIMTARIA  
**10%**

TREGTIA  
**48%**

TURIZMI  
**3%**

TË TJERA  
**21%**

Financimi me kredi sipas sektorëve  
Banka Qendrore e Kosovës 2019

Financimi i ndërmarrjeve, respektivisht bizneseve në Kosovë ka arritur vlerën 1.87 miliardë euro dhe kjo shënon mbi 10% rritje vjetore të financimit të bizneseve në Kosovë. Rritja e financimit me kredi të reja ndaj bizneseve në vitet e fundit tregon potencialin e vazhdueshëm të rritjes së bizneseve në vend në sektorë të ndryshëm ekonomik. Me rëndësi të veçantë është sektori i prodhimit, i cili ka shënuar rritjen stabile më të lartë në tri vitet e fundit. Vetëm në tremujorin e dytë të këtij viti financimi ndaj bizneseve prodhuese u rrit për 10 milionë euro, duke arritur kështu mbi 14% pjesëmarrje në total financimin e ndërmarrjeve në sektorin bankar. Tregtia mbetet sektori me pjesëmarrjen më të lartë në financim gjë që reflekton edhe bilancin tregtar të Kosovës dhe varshmërinë ndaj importeve.

Banka ProCredit ka vendosur fokus te vecante per bizneset me aktivitet prodhimin, duke besuar fuqishem qe jane keto biznese qe sjellin rritje ekonomike, vende te reja pune dhe poashtu te ndikojne ne rritjen e eksportit. Përveç politikave të financimit, këto biznese përkrahen në mënyrë të vecantë në aspektin e këshillimit dhe përkrahjes në qasjen në tregjet regjionale përmes rrjetit regjional të bankave ProCredit. Financimi në sektorin e prodhimit në bankën ProCredit arrin në mbi 22% të portfolios aktuale të kredive ndaj bizneseve.

Sfidë kryesore e bizneseve në përgjithësi ka qenë qasja në financim, por me zhvillimet e fundit në treg dhe rritja e financimit të NVM-ve reflekton përmirësim të dukshëm në këtë aspekt. Por, sfiduese në edhe më tutje për qasje më të lehtë në financim të bizneseve në përgjithësi mbesin të dhënat asimetrike financiare të bizneseve dhe formalizimi.

Sfidë tjetër nga ana e bizneseve mbetet përfshirja e tyre në zingjirin e vlerave globale (global value chains), që do të ndikonte në forcimin e NVM-ve si prodhues vendor duke përfutur njohuri

nga qasja në tregje të huaja dhe teknologji të reja, të cilat përvoja kanë efekt pozitiv në rritje të produktivitetit të tyre. Qasja në tregjet ndërkombëtare do të përmirësojë kualitetin e shërbimeve dhe produkteve të NVM-ve duke arritur plotësimin e standardeve dhe certifikimeve të nevojshme, do të ngriste aftësitë menaxheriale të tyre dhe do të mundësonte krijimin e planeve investive më fizibale dhe më të përshtatshme karshi nevojave të ekonomise jo vetëm vendore por edhe trendeve ndërkombëtare.

Ne anën tjetër, sektor me potencial të lartë zhvillimi por me sfida me të theksuara mbetet sektori I energjisë së ripërtëritshme. Ndër direktivat evropiane të cilat duhet përmbushur Kosova janë rritja e konsumit të energjisë së ripërtëritshme dhe zvogëlimi i ndotjes së ambientit. Kosova dhe regjioni përreth ofrojnë potencial të madh të energjive të ripërtëritshme. Aktualisht nevojat e Kosovës dhe të regjionit përreth mbulohen kryesisht nga energjia e prodhuar nga qymyri dhe uji, ku energjia e nevojshme shtese importohet. Përmes shfrytëzimit të vecorive natyrore si uji, dielli dhe era ofrohen shanse për të zhvilluar zinxhira të reja të vlerave të shtuara. Në Kosovë dhe në regjion janë duke u startuar respektivisht tanimë janë duke u zhvilluar shumë projekte të reja dhe aktive për gjenerim të energjisë nga era, uji dhe dielli. Tema si siguria e furnizimit me energji, zgjerimi i rrjetit, kursimi i energjisë, investimet dhe zhvillimi i projekteve në prodhimin e energjisë konvencionale dhe të ripërtëritshme si dhe zbatimi i obligimeve të liberalizimit janë vetëm një pjesë e problemeve aktuale në Kosovë. Pengesë kryesore e bizneseve për zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme mbetet jo vetëm mungesa e të dhënave të sakta dhe të plota për burimet e energjisë dhe për lëvizjet historike të këtyre burimeve (reshjet, erërat, diellin) por edhe definimi i rregullativës dhe vendosja e tarifave nëntëse



**Financimi i ndërmarrjeve, respektivisht bizneseve në Kosovë ka arritur vlerën 1.87 miliardë euro dhe kjo shënon mbi 10% rritje vjetore të financimit të bizneseve në Kosovë.**

për të gjitha burimet e energjisë në linjë me nevojën e bizneseve. Vetëm kështu mund të nxiten investimet në energji të ripërtëritshme nga ana e bizneseve, në mënyrë që të paktën të shfrytëzohen resurset natyrore që Kosova zotëron.

Kredite për financim të energjisë së ripërtëritshme janë zhvilluar me theks

të shtuar nga banka ProCredit tashmë disa vite. Planet e bizneseve për investime në kursimin e energjisë, investime në burime të energjisë së ripërtëritshme, dhe investime të tjera ekologjike miqësore jo vetëm që përkrahen por edhe këshillohen nga ana e bankës. Duke marrë parasysh rolin e këtyre investimeve në mjedis dhe efektin pozitiv jo vetëm në uljen e kostove të energjisë nga ana e bizneseve por edhe uljen e efektit negativ në mjedis, banka financon këtë sektor strategjik me kushte të vecanta. Duke financuar investime të tilla të bizneseve në kontribuojmë në promovimin e bizneseve ekologjike miqësore me kosto të ulët të energjisë dhe stimulojmë ekonominë e gjelbër në Kosovë.

**ARDIAN KADRIJA**Drejtor i Shërbimit për Punë Juridike  
NLB Bank

# Sfidat dhe mundësitë e sistemit financiar në Kosovë në kontekstin ligjor



**S**istemi ligjor në Kosovë është duke u reformuar në vazhdimësi me qëllim të fuqizimit të kornizës ligjore për të gjithë sektorët e bizneseve. Progresi në plotësimin dhe pasurimin e kornizës ligjore ka dhënë efekte pozitive të konsiderueshme, si në qeverisjes korporative por edhe në implementimin e praktikave sa më të mira nga ana e kompanive që veprojnë në Republikën e Kosovës. Problemi serioz juridik që i ka sfiduar bankat komerciale në Kosovë në vazhdimësi, ishte edhe përcaktimi i titullarit të

pronësisë mbi paluajtshmerinë të cilat shpeshherë janë bërë pengesë e zhvillimit të kompanive përmes mbështetjes së sektorit bankar. Projekti i Bankës Botërore në Kosovë për Pronën e Paluajtshme dhe Kadastrin e ka përmirësuar dukshëm përcaktimin e të drejtave pronësore dhe ka krijuar një siguri juridike tek investitorët në njëerë anë, por edhe duke ju mundësuar personave fizik dhe juridik që ta shfrytëzojnë të drejtën mbi pronën e tyre, për ta ofruar të njëjtën si kolateral për çasje në kredimar-

rje në bankat komerciale dhe për rrjedhojë edhe vet sektorin financiar në Kosovë. Sektori financiar pavarësisht reformave në kornizën ligjore, ende ballafaqohet me probleme serioze për shkak të vonesave në miratimin e rregulloreve përkatëse që ndërlidhen drejtpërdrejt me sektorin bankar, ndërsa pozitive është hyrja në fuqi e Ligjit për Falimentimin i cila ka filluar të zbatohet në praktikë edhe pse ka mungesë të përvojës praktike në çështjet e falimentimit si dhe nevojës për trajnime të mëtutjeshme për gjyqësorin dhe komunitetin afarist. Ligji për Falimentim është më shumë i përqendruar në gjetjen e mënyrës së riorganizimit dhe ristrukturimit të korporatave, me qëllim të vazhdimin të veprimtarisë së tyre në mënyrë efektive duke i ruajtur njëkohësisht edhe vendet e punës.

Sfidat ligjore me të cilat ballafaqohen bankat komerciale në Kosovë janë edhe çasja e dobët, vonesat dhe numri i madh i lëndëve të pazgjidhura në të gjitha Gjykatat, edhe pse janë duke u bërë përpjekje për reforma të thella gjyqës-

ore në Kosovë për rritjen e kapaciteteve në zgjidhjen së kontesteve të ndryshme, përfshirë këtu edhe projektin për themelimin e një Gjykate të veçantë Ekonomike. Aktgjykimet e Gjykatave kompetente janë duke u bërë publike dhe kjo e rrit besimin e sektorit bankar dhe të investitorëve tjerë në sistemin gjyqësor dhe i kontribuon përmirësimit të mjedisit afarist. Sfidë tjetër ligjore për sektorin Bankar ishte edhe mungesa e një Rregulloreje për kamatëvonesën e produkteve kreditore, e cila i kishte shtyrë Bankat që ta përcaktojnë secila sipas mënyrës së vet kamatëvonesën e produkteve kreditore, mirëpo në fund të muajit gusht 2019, Banka Qendrore e Kosovës e kishte publikuar dhe futur në fuqi edhe këtë Rregullore për Kamatëvonesën e Instrumenteve Kreditore, e cila është një mundësi e mirë për Bankat që ti unifikojnë kontratat e tyre me klientët, për sa i përket kësaj çështje. Ministria e Drejtësisë, në kuadër të




Sfidat ligjore me të cilat ballafaqohen bankat komerciale në Kosovë janë edhe çasja e dobët, vonesat dhe numri i madh i lëndëve të pazgjidhura në të gjitha Gjykatat, edhe pse janë duke u bërë përpjekje për reforma të thella gjyqësore në Kosovë për rritjen e kapaciteteve në zgjidhjen së kontesteve të ndryshme, përfshirë këtu edhe projektin për themelimin e një Gjykate të veçantë Ekonomike.

kompletimit të infrastrukturës ligjore në fushën e drejtësisë, si një ndër prioritetet themelore të saj e ka edhe kodifikimin e materies së të drejtës civile dhe kjo do të ishte një ndër projektet më të mëdha në kornizën ligjore të Republikës së Kosovës që nga pas lufta. Vlen të cekët se edhe legjislacioni aktual i Republikës së Kosovës në fushën e së drejtës civile, mund të thuhet se është hartuar duke i respektuar parimet e së drejtës së Bashkimit Evropian. Në këtë proces, një kontribut të veçantë e kanë dhënë USAID dhe Bashkimi Evropian përmes përkrahjes së drejtpërdrejtë të tyre gjatë hartimit të legjislacionit. Kjo nënkupton se ligjet që mbulojnë fushën e së drejtës civile janë të hartuara në frymën e Legjislacionit të BE-së dhe nuk i cenojnë parimet e tij dhe si rrjedhojë kjo e pasqyron edhe mundësinë e arritjes së suksesit të sistemit bankar në Kosovë, përmes sigurisë juridike.



**NLB Banka**

Për gjithçka që vijon!




**Paguaj me kuletën digjitale nga telefoni juaj.**



**MERITA HYSAJ**

Menaxhere e Operacioneve të Kredive  
dhe Biznesit Dokumentar  
TEB Sh.A.

**ALBERITA MEMQAJ**

Mbikëqyrëse e Biznesit Dokumentar  
TEB Sh.A.

# Sfidat e financimit të tregtisë ndërkombëtare në Kosovë

**T**ë bërit biznes përtej kufijve të shtetit bartë në vete më shumë rrezik se brenda vendit, duke pasur parasysh kompleksitetin e tregtisë ndërkombëtare që vjen si rezultat i dallimeve në valutë, gjuhë, kulturë, gjendjes politike, si dhe legjislacionit që aplikohet në vendet e ndryshme. Shqetësimi kryesor në tregtinë ndërkombëtare është mospërbushja e pagesës për mallin apo shërbimin e kontraktuar. Shitësi kërkon përmbushje korrekte të obligimit të pagesës ndërsa blerësi pranimin e mallit në formën, sasinë dhe kualitetin e dëshiruar. Rruga e zakonshme në vendet në zhvillim për të bërë biznes është pagesa në para të gatshme. Shpesh humben shuma të mëdha parash përshkak të mos definimit të qartë të kushteve dhe afateve në kontratat biznesore, si dhe pagesave në avans në formë të transfereve ndërkombëtare. Kjo formë e pagesës e dëmton kryesisht importuesin,


Rreth 80% e transaksioneve në tregtinë ndërkombëtare shumicën e rasteve kërkojnë financim prej bankave apo kompanive të sigurimit.<sup>1</sup> Edhe përkundër avancimit të vazhdueshëm të formave të financimit të tregtisë ndërkombëtare në botë akoma rolin kryesor e kanë produktet tradicionale si Letër Kredia dhe Letër Garancioni. Vlera totale e tregtisë së mallrave në botë gjatë vitit 2018 ka arritur shifren prej 19.67 trilion dollarë, ndërkaq kërkesa e tregut për financimin e tregtisë që nuk arrihet të plotësohet vlerësohet të jetë rreth 1.5 trilion dollarë në vit<sup>2</sup>. Pra, zhvillimi dhe avancimi i financimit të tregtisë është esencial në mënyrë që tregtia globale të mos ngecë dhe boshllëku ekzistues të mos figurojë në raportet statistikore të së ardhmës.

<sup>1</sup> Burimi: Trade Finance and SMEs – Bridging the gap in provision, ÉTO 2016

<sup>2</sup> Burimi: Trade Finance and the Compliance challenge IFC, ÉTO

**Figura 1.** Vlera e kërkesës së paplotësuar për financim të tregtisë në botë





Tregtia botërore ka patur rritje të vazhdueshme përgjatë viteve 2008-2018 për **26%<sup>3</sup>**

Rritja e vazhdueshme e volumit të tregtisë në botë është shoqëruar edhe me rritjen e kërkesës për financim. Në anën tjetër bankat kanë shtuar kontrollat financiare në mënyrë që të parandalohen, luftohen dhe më lehtë të raportohen skema të ndryshme mashtrimi dhe keqpërdorimi nga profesionistët e kësaj fushe. Të gjitha këto kërkesa të bankave janë masa preventive që ndihmojnë në ruajtjen e reputacionit të institucionit, rritjen e sigurisë në realizimin e transaksionit duke krijuar kështu mjedis të sigurt në zhvillimin ekonomik.

Për transaksionet ndërkombëtare ku mund të përfshihen palët nga shtetet e ndryshme me distanca të largëta gjeografike, dhe që i ekspozohen rreziqeve komerciale e politike, ndërmjetësimi i bankave është i domosdoshëm për të minimizuar këto rreziqe. Kjo arrihet përmes ekspertizës së profesionistëve të përkushtuar në kontrollimin e dokumentacionit të kërkuar në transaksionet në fushën e tregtisë ndërkombëtare, si dhe shkëmbimit të përvojave brenda rrjetit të gjerë mes bankave për transaksionet e ngjashme apo klientët e njejtë.

TEB SH.A., si pjesë e familjes së BNP Paribas e cila u vlerësua nga Global Finance<sup>4</sup> si banka më e mire në shërbimet për financimin e tregtisë, ka ndërmjetësuar në shumë transaksione komplekse në Kosovë, duke ofruar likuiditet për klientët si dhe garanci në pagesa. Duke pasur parasysh që Kosova është shtet ende shumë i varur nga importi, përdorimi i metodave të financimit të tregtisë përmes bankës është i domosdoshëm për të siguruar një biznes të suksesshëm, i cili ndikon edhe në zhvillim e përgjithshëm ekonomik. Vlera e përgjithshme e importit të mallrave në Kosovë gjatë periudhës 2016-2018 ka shënuar rritje shumë më të lartë se eksporti sikurse shihet në tabelën më poshtë.

<sup>3</sup> Burimi: World statistical Review Trade Review 2019

<sup>4</sup> Global Finance -The Magazine -February 2019-World's Best Trade Finance Providers 2019: Getting The Paper Out

**Tabela 1.** Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme në Kosovë (Burimi: ASK 2019)

## Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme në Kosovë



## SEKTORI FINANCIAR

Në tregtinë ndërkombëtare, përveq rrezikut komercial, paraqiten edhe shumë sfida tjera. Importuesit shpesh humbin mundësinë që të bashkëpunojnë me partnerë biznesi ndërkombëtarë për shkak të kërkesave të larta për kolateral nga bankat, sanksioneve të ndryshme dhe zbatimit të rregulloreve të reja kundër shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit etj. Pjesëmarrësit në treg që ballafaqohen më së shumti me këtë sfidë janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të). Meqenëse NVM-të përfaqësojnë 95% të kompanive në botë dhe 60% të vendeve të punës në sektorin privat<sup>5</sup> duke qenë kështu kontribuesit kryesor në krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimit të ekonomisë, kanë nevojë për qasje më të thjeshtësuar në financim.

Mungesa e njohurive rreth ekzistimit dhe mënyrës së përdorimit të produkteve të financimit të tregtisë ndërkombëtare përmes institucioneve financiare është një sfidë tjetër si për NVM-të ashtu edhe për pjesëmarrësit tjerë në treg.

Një formë e re e financimit në Kosovë është Faktoringu. Kjo u mundësua me krijimin e bazës ligjore nga Banka Qendrore e Kosovës përmes Rregullores për Faktoring të publikuar në vitin 2018. Përmes faktoringut bizneset mund të kenë

<sup>5</sup> <https://iccwbo.org/global-issues-trends/banking-finance/access-trade-finance/>



Nganjëherë, në momentin që ndalet tregtia, fillon lufta. Tregtia është mënyrë për të ndërtuar besim dhe jo armë për të luftuar njëri tjetrin

**Jack Ma,**  
**Themelues i**  
**Alibaba Group**



qasje më të lehtë në financim duke evituar problemet për sigurimin e kolateralit, pasi që kjo formë e financimit mund të mbulohet me faturat e furnizuesit si kolateral. Në shtetet e rajonit kjo formë e financimit ka gjetur përdorim të gjerë. Edhe në Kosovë do të mund të krijoheshin kushte të favorshme për shfrytëzimin e kësaj mundësie financimi përmes promovimit dhe trajnimeve si dhe duke treguar gatishmeri për avansim të produktit në përshtatje me aftësitë e tregut. Tregut të Kosovës sot i japin mbështetje shtesë edhe IFC (International Finance Corporation) si pjesë e Bankes Botërore dhe EBRD (European Bank for Recon-

## BERZH

	Programi i Lehtësimit të Tregtisë (TFP)
Numri i vendeve të operimit	26
Llojet e produkteve financiare	1. Garantuesit lëshuan instrumente të financimit të tregtisë, p.sh. L / Cs, SBL / Cs, pagesa të kryera në avanc, obligacione të ofertës dhe performancës, shënime premtuese në lidhje me tregtinë dhe fatura të këmbimit. 2. Kredi afatshkurtra për bankat e zgjedhura dhe kompanitë faktorizuese
Numri i transaksioneve që nga fillimi	21000
Vlera e transaksioneve që nga fillimi	US \$ 18.5 miliardë
Numri i transaksioneve në 2017	US \$ 2.3 miliardë
Pretendimet deri më sot	2





Tregtia është si rrjedhë e ujit, gjithmonë gjen rrugën përmes pengesash

**Ruediger Geis,  
Commerzbank**

EBRD poashtu jep kredi afatshkurtra për bankat dhe kompanitë e faktoringut në vendet ku operon për të financuar kompanitë vendore para dërgesës, financim pas dërgesës dhe forma të tjera të financimit për kontratat tregtare ndërkombetare dhe faktoringut ndërkombetar dhe vendor.

Ndërmjetësimi i këtyre institucioneve, duke ofruar garanci shtese rrit besueshmërinë në kryerjen e transaksioneve apo thënë ndryshe mbush boshllëkun e mosbesimit në tregtinë mes partnerëve që nuk njihen mes vete.

Sipas raportit të vitit 2017 të ICC-se<sup>6</sup>, nga totali prej 78 mijë transaksioneve të procesuara me mbështetjen e IFC dhe EBRD që nga themelimi i programeve, vetëm dy transaksione kanë rezultuar me dështim të palëve në përmbushjen e obligimeve. Kjo shihet më mirë në tabelën më poshtë:

Përkundër gjithë vështirësive, rreziqeve dhe sfida, përdorimi i produkteve të financimit përmes institucioneve financiare, vendosja dhe zbatimi i gjithanshëm i rregulloreve dhe restriksioneve të sigurisë financiare; bashkëpunimi me i afërt i bankave me rregullatorin është i domosdoshëm dhe siguron funksionim cilësor dhe të sigurt të biznesit në Kosovë.

<sup>6</sup> Burimi: 2018 Global Trade-Securing future growth, ICC global Survey on Trade Finance)

struction and Development). Ato ofrojnë programe të mira financimi krahas trajnimeve përkatëse. Si platforma e IFC-së ashtu edhe programi i EBRD-së kanë për qëllim të lidhin institucionet financiare në tregjet në zhvillim me bankat ndërkombetare për lehtësimin e tregtisë dhe krijimin e mundësive për NVM-të dhe korporatat që të marrin pjesë në zinxhirin global tregtar.

Këto institucione mund të garantojnë cdo transaksion në dhe nga shtetet ku veprojnë duke shtuar konfirmimin për: Letër Kreditë Dokumentare, bondet për pagesë në avans, garancionet bankare, 'promissory notes' dhe kambialet.

## IFC

### Programi Global i Financave të Tregtisë (GTFP)

26

GTFP siguron mbulim deri në 100% të vendit dhe rreziqeve tregtare të instrumenteve individuale të lidhura me tregtinë. Programet e tjera të tregtisë përfshijnë GTLP (Portofol i Financuar / i Pa Financuar), CCFP, GĚFP (Financat e Mallrave), GTST (Tregtia e strukturuar), Solucionet e Kapitalit punues dhe GTSF (Financuesi i Furnizuesit).

57000

US \$ 64 miliardë

US \$ 6.7 miliardë

0



**FATON RAMADANI**  
MENAXHER I RISKUT  
IŞBANK - DEGA NË KOSOVË

# Menaxhimi i riskut të modeleve

## Zhvillimi, validimi dhe zbatimi i modeleve

**B**ankat mbështeten shumë në analizë sasiore dhe në modele në shumicën e aspekteve të procesit të vendimmarrjes financiare. Si rutinë, ato përdorin modelet për një spektër të gjerë aktivitetesh, duke përfshirë sigurimet kreditore; vlerësimin e ekspozimeve, instrumenteve dhe pozicioneve; matjen e riskut; përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe rezervës; dhe shumë aktivitete të tjera. Vitet e fundit, bankat në nivel global kanë aplikuar modelet për produkte më komplekse dhe me fushëveprim më ambicioz, ndërkohë që tregjet ku ato operojnë gjithashtu janë zgjeruar dhe ndryshuar. Në këtë drejtim, ka disa ndryshime në kornizën rregullatore bankare të Kosovës që po ashtu kanë inkurajuar disa nga zhvillimet e fundit, veçanërisht në menaxhimin e riskut kreditor, bazuar në kornizën e Komitetit të Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare si dhe Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar.

Çdo bankë që përdor modele financiare është drejtpërdrejt e ekspozuar ndaj riskut të modeleve, që paraqet potencialin për pasoja të pafavorshme nga vendimet bazuar në autpute dhe raporte të gabuara ose të keqpërdorura të modelit.

Risku i modeleve mund të çojë në humbje financiare, vendimmarrje të dobët afariste dhe strategjike, apo mund ta dëmtojë reputacionin e bankës.

Kjo është arsyeja pse për të gjitha bankat në Kosovë ka rëndësi thelbësore që të kenë menaxhim të shëndoshë të riskut të modeleve i cili përfshin zhvillimin, zbatimin dhe përdorimin e rreptë të modeleve krahas procesit të shëndoshë për validim të modeleve. Më poshtë do të përshkruaj shkurtimisht secilin prej këtyre elementeve të procesit të menaxhimit të riskut të modelit.

### ZHVILLIMI I MODELIT

Procesi i zhvillimit të modelit mund të ndryshojë ndjeshëm, varësisht nga ajo që modelohet, kërkesat rregullatore, preferencat e bankave dhe modeluesve të tyre, dhe qasjet e zgjedhura të modelimit. Sidoqoftë, zhvillimi i modelit kalon përmes një procesi i cili ka një ngjashmëri të përbashkët në pothuajse çdo institucion. Secili zhvillim i modelit fillon me fazën e vlerësimit dhe planifikimit, ku zhvilluesit e modelit vlerësojnë dhe rishikojnë detajet e portofolit, modelet ekzistuese, nëse ka, dhe kërkesat, qoftë nga rregullatorët ose vlerësuesit e

brendshëm. Në këtë fazë, fushëveprimi dhe objektivi i zhvillimit të modelit duhet të vendoset dhe të shprehet qartë. Hapi i radhës, që është proces i gjatë dhe i lodhshëm, është mbledhja e të dhënave. Modeli në vetvete varet nga cilësia e të dhënave dhe mënyra e organizimit të tyre.

### Faza tjetër, dhe më e rëndësishmja, është zhvillimi i modelit që kalon në hapat e mëposhtëm:

- Analiza eksploruese e të dhënave
- Segmentimi i të dhënave
- Përzgjedhja dhe vlerësimi i variablave
- Diagnostikimi i modelit
- Testimi i performancës

### VALIDIMI I MODELIT

Gjatë kësaj faze, modelet duhet të validohen në mënyrë të pavarur nga ekipi i menaxhimit të riskut të modeleve. Validimi mund të bëhet edhe nga kompani të specializuara të jashtme. Validuesit shqyrtojnë kodet dhe dokumentet e zhvilluesve të modelit dhe përpiqen të gjejnë ndonjë cenueshmëri në model. Normalisht, gjetjet dhe rekomandimet ndahen me zhvilluesit e modeleve për veprime të mëtejshme. Validimi i modelit ka



rëndësi thelbësore për organizatën për të siguruar cilësinë e zhvillimit të modeleve. Por, zhvilluesit e modeleve nuk do të duhej t'i shohin validuesit si "armiç" të tyre, sepse në realitet validuesit sigurojnë që modeli është në përputhje me kërkesat e brendshme dhe rregullatore. Nga ana tjetër, validuesit jo vetëm që do të duhej të bëjnë çmos që t'i gjejnë boshllëqet në model, por rrjedhimisht do të duhej t'i ndihmojnë zhvilluesve të modeleve që puna e tyre të rezultojë me model të cilësisë së lartë duke u rekomanduar dhe duke i udhëzuar ata si të përmirësojnë mangësitë e mundshme në model.

## ZBATIMI I MODELIT

Më në fund, modeli është ndërtuar, validuar dhe rekomandohet për përdorim. Tani është koha për të zbatuar modelin. Zbatimi i modelit nuk është



Bankat në nivel global kanë aplikuar modelet për produkte më komplekse dhe me fushëveprim më ambicioz, ndërkohë që tregjet ku ato operojnë gjithashtu janë zgjeruar dhe ndryshuar.

edhe aq punë e lehtë. Ekipet të përbëra nga programuesit dhe administratorët e bazave të të dhënave dhe hisedarët e tjerë punojnë ngushtë për të siguruar që modeli zbatohet në mënyrë të saktë dhe efektive.

Një element i rëndësishëm që nuk u përmend më lart është rregullimi, i cili përcakton kornizën efektive me role dhe përgjegjësi të përkufizuara për komunikim të qartë të kufizimeve dhe supozimeve të modelit, si dhe autoritetin për të kufizuar përdorimin e modelit.

Menaxhimi i riskut të modeleve kërkon gjithashtu resurse të sofistikuar teknologjike dhe personel të kualifikuar, si dhe aftësim të vazhdueshëm të stafit të angazhuar gjatë gjithë procesit të zhvillimit të modeleve për shkak të kompleksitetit të modeleve për nga natyra e tyre dhe ndryshimeve të shpejta me kalimin e kohës.

**MUHAMET ALIU**

MENAXHER I KONTABILITETIT FINANCIAR  
RAIFFEISEN BANK KOSOVË

# Normat bazë dhe sektori bankar - sfidat para nesh!

**N**ormat e interesit janë mjet i rëndësishëm për përcaktimin e politikave makroekonomike. Në kohë të recesionit ekonomik, normat ulen nga Banka Qendrore në mënyrë që huamarrja të bëhet më pak e kushtueshme për bizneset dhe të nxiten investimet e reja në ekonomi. Kjo do të duhej të injektojë më shumë fonde në ekonomi dhe kështu të nxitet rritja e përgjithshme ekonomike dhe të ulet papunësia.

Bankat do të jenë ndërmjetëse në procesin e ndryshimit makroekonomik duke përshtatur normat e huadhënies për klientët e tyre dhe duke kompensuar

të ardhurat e zvogëluara me përshtatjen e normave ato do të paguajnë detyrimet të cilat në pjesën më të madhe përbëhen nga depozitat e klientëve.

Pra, është e logjikshme që të merrni kredi hipotekare nga banka dhe të paguani interes të caktuar ose të ndryshueshëm, dhe t'i depozitoni kursimet tuaja në bankë dhe të fitoni interes. Por, kanë kaluar disa vite që kjo praktikë shekullore më nuk është “e zakonshme” në BE. Ndikuar nga kriza e vitit 2008 dhe ekonomia e dobët evropiane, BQE uli normat bazë të interesit në -0.5 për qind në shtator 2019.

Viti	Me efekt nga	Norma e BQE
2019	18 shtator	-0.50
2016	16 mars	-0.40
2015	9 dhjetor	-0.30
2014	10 shtator 11 qershor	-0.20 -0.10
2013	13 nëntor 8 maj	0.00 0.00
2012	11 korrik	0.00
2011	14 dhjetor 9 nëntor	0.25 0.50



Bankierët tradicionalistë mund të thonë se kjo është vetëm përshtatje e përkohshme ndaj kushteve të tregut derisa ekonomia Evropiane të fillojë të rimarrë veten. Por, ky mund të jetë realiteti për një pjesë të kohës që vjen. Sipas një numri ekspertësh situata do të mbetet kështu të paktën deri në vitin 2021.

BQE ka ndërmarrë këtë hap si mjet për të mbajtur të ulët koston e huamarrjes dhe për të rritur shkallën e investimeve në ekonomi. Kjo ishte menduar të ndihmonte ekonominë që të rimëkëmbej nga kriza. Normat negative kanë ndikuar në bankat komerciale, si dhe duke ndryshuar modelin e rregullt të investimeve në aktivet monetare. Kjo ka çuar në rritjen e vëllimit të parave të gatshme që bankat i mbajnë në kasafortat e tyre si rezultat i interesit negativ nga investimet qoftë në vendosjen e parave në treg ose në Bankat Qendrore. Parashtrohet pyetja: a janë bankat evropiane të gatshme për këtë “sfidë” të re? Bazuar në një numër ekspertësh të ekonomisë, normat bazë negative në BE, nga roli i tyre si instrument afatshkurtër, kanë kaluar në “varësi”. Në një artikull të botuar në WSJ, ekonomisti Brian Blackstone konstaton si vijon:

*“Joefektiviteti i politikës së normës negative është shenjë se sa të dobët janë motorët ekonomikë të Evropës por edhe sa të cenueshëm. Politika kërcënon pensionet, krijon riskun e fluskave të*



Ndërsa nuk besoj se BQE ka arritur brezin e ulët efektiv të normave të politikave, është e qartë se normat e ulëta kanë implikime për sektorin bankar dhe stabilitetin financiar në përgjithësi

**Christine Lagarde,  
presidentja e  
zgjedhur e BQE**


*patundshmërive dhe nuk shuan plotësisht spektrin e deflacionit. Bankat Evropiane kanë kokëçarje me të ardhura të ulëta nga interesi dhe marzha të holla në huadhënie, duke i lënë ato pas bankave amerikane për nga rentabiliteti dhe duke e bërë më të vështirë për to financimin e ekonomisë.”*

Kështu, nëse ulja më e fundit e normës nga -0.4 në -0.5 për qind do të ndihmojë ekonominë ose do t'i përkeqësojë punët për bankat komerciale të zonës së BE mbetet çështje që do ta shohim në të ardhmen!

Ky trend në njëfarë mënyre po i dëmton gjeneratat e reja në kuptim të kursimit për të ardhmen. Një numër i të rinjve që kanë kursyer nga puna e tyre me mund do të shohin zvogëlimin e kursimeve të tyre me kalimin e kohës. Një numër i tyre në vendet e BE kanë ndërmarrë hapa për të investuar në patundshmëri, në disa raste pasuri boshe, për të shmangur koston e mbajtjes së parave të gatshme. **Është thjesht më pak e kushtueshme të investohet në patundshmëri boshe sesa të mbash para të gatshme.**

Në këtë realitet të ri në ekonomi, tronditja më e fundit erdhi nga Danimarka. Banka daneze JYSKE filloi me ofrimin e hipotekave të para me norma negative në botë në gusht të këtij viti. Norma që ngarkohet është minus 0,5 në vit. Normat negative të interesit në të vërtetë nënkuptojnë se banka

## Normat e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës <https://bqk-kos.org>

e paguan huamarrësin për t'ia hequr paratë nga dora, kështu që ai lan borxh më pak sesa që ka marrë hua. Deri më tani, diçka e tillë do të dukej si tregim fanta-shkencë. Por, ky shembull nga JYSKE për hipotekat dhjetëvjeçare ku banka ju paguan që të merrni hua e ndërrojnë lojën. Ai gjithashtu mund të shërbejë si mësim për sektorin bankar lidhur me atë që mund të vijë në të ardhmen.

Po si qëndron puna me bankat lokale që operojnë në tregun e Kosovës. Në statistikën e publikuar nga BQK kemi parë se normat e interesit të huadhënies nga bankat kanë rënë vit pas viti.

### CILA ËSHTË NORMA MË E ULËT QË MUND TA MBAJË TREGU FINANCIAR I KOSOVËS PA HYRË NË KRIZË TË THELLË?

Kjo kosto e normave negative padyshim që do të zhvendoset drejt depozitave të klientëve. Por, normat tani janë o në shumicën e bankave lokale. Nëse trendi i rënies së normave vazhdon më tej në kredi dhe normat negative mbizotërojnë në BE, atëherë, të paktën një pjesë e kësaj kostoje do të alokohet te detyrimet e bankës. Kjo nënkupton kosto shtesë



**Bankierët tradicionalistë mund të thonë se kjo është vetëm përshtatje e përkohshme ndaj kushteve të tregut derisa ekonomia Evropiane të fillojë të rimarrë veten. Por, ky mund të jetë realiteti për një pjesë të kohës që vjen. Sipas një numri ekspertësh situata do të mbetet kështu të paktën deri në vitin 2021.**

për mbajtjen e parave të gatshme në bankë për bizneset vendore dhe individët privatë. Ne kemi parë që kostot për të pasur llogari bankare janë rritur pothuajse në të gjitha bankat lokale. Kjo është në përputhje me trendet në një numër vendesh të tjera në BE ku bankat tani po ngarkojnë tarifa për depozitimin e parave të gatshme në llogarinë rrjedhëse në bankë. Në të ardhmen, potencialisht do të mund të shohim gjithnjë e më shumë njerëz duke marrë vendimin për të investuar në pa-tundshmëri apo tregje të kapitalit në mënyrë që të ruajnë vlerën e kursimeve dhe të përfitojnë potencialisht nga luhatjet në treg.

Bankat do të duhet të përshtaten me epokën e re të punëve bankare dhe të përfshijnë më shumë produkte që dallojnë nga biznesi tradicional i depozitave dhe i huave. Kjo nënkupton shtimin e më shumë mundësive për investime dhe diversifikim të portofolit për qëllime të veta dhe për bazën e klientëve të saj. **Gjendemi para një epokë të re entuziazmuere për sektorin bankar në Kosovë, ku bankat do të duhet të paraqesin kreativitetin e tyre në mënyrë që të krijojnë kthim të pranueshëm nga ekuiteti, por gjithashtu të ofrojnë vlerë për klientët e vet.**



**ARBËR HALILAJ**  
MENAXHER FILIALE  
RAIFFEISEN BANK KOSOVË

# Dixhitalizimi si trend në industrinë bankare në Kosovë

**Bankat tradicionale në Evropë tanimë po përballen me një konkurrencë të madhe, që nuk ka të bëjë vetëm me bankat tjera në të njëjtin treg, por edhe me organizatat tjera që ofrojnë shërbime të ndryshme financiare, kompanitë e tjera si Paypal, Fintech, të cilët kanë sistemet e tyre të pagesave.**

Rreth nesh gjithçka po ndryshon dhe po transformohet, kështu që procesi i dixhitalizimit të bankave në rajon, por edhe në Kosovë, ka një perspektivë të madhe dhe duhet të eksplorohej potenciali i plotë. Në mënyrë që bankat tek ne të vazhdojnë të jenë të suksesshme dhe konkurruese, dixhitalizimi si proces do të mundësojë të kuptojmë nevojat e klientëve tanë, duke iu siguruar pastaj cilësi të shërbimeve bankare dhe për të krijuar vlera. Sipas të dhënave të FMN-së, viti 2019 do të jetë viti i dhjetë i njëpasnjëshëm i rritjes së GDP reale prej më shumë se 3.5% në rang botëror, ashtu si edhe në ShBA prej 2.9%. Në të njëjtën kohë, Zona e BE-së, Evropa Qendrore dhe Lindore po përjetojnë rritjen më të shpejtë që nga kriza e fundit, kështu që GDP-ja në Evropën Lindore u rrit me një mesatare prej 3.2% në vitin 2018 sipas FMN-së. Poashtu, kemi një kreditim stabil me një trend pozitiv të rritjes prej rreth 5% gjatë tre viteve të fundit (2017 - 2019). Kjo rritje ekonomike dhe shitja e borxheve të këqija, ka ulur përqindjen e kredive joperformuese, gjë që ndikon në profitin e bankave në rajon.




ZONA E BE-SË, EVROPA QENDRORE DHE LINDORE PO PËRJETOJNË RRIJTEN MË TË SHPEJTË QË NGA KRIZA E FUNDIT, KËSHU QË GDP-JA NË EVROPËN LINDORE U RRIJT ME NJË MESATARE PREJ

## 3.2%

NË VITIN 2018 SIPAS FMN-SË.

Vendet e rajonit, përfshirë edhe Kosovën, kanë nivel solid të zhvillimit të teknologjisë informative (IT) për të dixhitalizuar dhe automatizuar proceset, ndërsa infrastruktura dixhitale në këto vende është në nivel të ngjashëm si në shtetet më të përpunuara të Evropës Perëndimore. Duke përmirësuar shërbimet ndaj klienteles


përmes dixhitalizimit, bankat mund t'i kushtojë më shumë kohë klientelës që ka pritshmëri të larta sa i përket shërbimit të shpejtë. Së bashku me trendin e dixhitalizimit në banka, gjithashtu kemi lulëzimin e kompanive "fintech" në Evropë, veçanërisht në sektorët e transaksioneve dhe pagesave, financimit të shpejtë dhe investimeve. Bankat kontaktojnë klientët e tyre përmes të gjitha kanaleve të mundshme (duke vizituar klienti filialen, kontaktimi përmes Qendrës së Thirrjeve-telefonatave, sms, live chat etj.) për t'iu lehtësuar atyre çasjen, komunikimin dhe ofrimin e shërbimit më të mirë të mundshëm. Në favor të dixhitalizimit shkon edhe fakti se në Evropën Lindore gati 50% e popullsisë është nën 35 vjeç, ndërsa në Kosovë 42.5% e popullsisë është madje deri në 19 vjeç. Shpërndarja e internetit në rajon tejkalon mesataren prej 60% të mbulueshmërisë, ndërsa pothuajse çdo person ka së paku një smartphone. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e studimit mbi penetrimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, që tregon se më shumë se gjysma e



familjeve në Kosovë përdorin teknologjinë ose shkalla e shpërndarjes së internetit në vend është mbi 88%, shumë më e lartë sesa mesatarja e rajonit.

Ky nivel i lartë i shtrirjes së Internetit në Kosovë e bën vendin të ngjashëm me vendet e BE-së sa i përket mundësive të infrastrukturës së teknologjisë dixhitale. Mbulueshmëria e vendit me internet në shkallë të gjerë është thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe social të Kosovës sipas standardeve të BE-së, si dhe për të shfrytëzuar mundësitë e ofruara përmes dixhitalizimit të sistemit bankar.

Në mënyrë që bankat në Kosovë të ofrojnë shërbime të nivelit të lartë ndaj klientelës, duhet të eliminohen futja manuale e të dhënave, proceset e ngadalshme dhe joefikase. Hyrja automatike e të dhënave dhe përpunimi i tyre, menaxhimi i të dhënave dhe automatizimi i proceseve të biznesit në banka, mundësojnë eliminimin e proceseve manuale. Për shërbime bankare efikase, nuk mjafton thjesht të



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS (ASK) KA PUBLIKUAR REZULTATET E STUDIMIT MBI PENETRIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT, QË TREGON SE MË SHUMË SE GJYSMA E FAMILJEVE NË KOSOVË PËRDORIN TEKNOLOGJINË OSE SHKALLA E SHPËRNDARJES SË INTERNETIT NË VEND ËSHTË MBI

88%

dixhitalizohen shërbimet e fokusuar tek klienti, por duhet të automatizohen dhe optimizohen të gjitha proceset e brendshme të bankës. Termi “bankë” që është interpretuar si filialë me sporte deri më tani, po ndryshon si model tradicional i organizimit të kanaleve të distribuimit brenda bankave. Pas krizës ekonomike botërore që filloi para një dekade, dixhitalizimi është procesi i fundit i konsolidimit dhe transformimit të veprimtarisë së sistemit bankar. Dixhitalizimi i proceseve të brendshme është një parakusht për dixhitalizimin e shërbimeve ndaj klientit, sepse rrit angazhimin, ia liron stafit një kohë të caktuar si dhe u jep atyre mundësinë për t'u fokusuar tek shërbimi efikas ndaj klientelës. Kjo përshejton shumë punën, ulen shpenzimet dhe arrihet efikasiteti i lartë.

Pavarësisht nga dixhitalizimi, shumë procese kyçe të punës në bankat e Kosovës dhe rajonit janë ende plot punë rutine me shkresa ("paperwork"). Bankingu dixhital duhet, në të vërtetë, të plotësojë metodat ekzistuese bankare tradicionale, dhe një miks i tillë i bankingut tradicional dhe dixhital duket të jetë mënyra më e mirë që bankat këtu të kenë sukses në ofrimin e shërbimeve ndaj klientelës së tyre. Dixhitalizimi faktikisht po ndodh si diçka e pashmangshme dhe bankat duhet të aplikojnë modelin më të përshtatshëm të tij, mirëpo nuk duhet harruar që ky proces ofron trajtim të njejtë ndaj një klientele të ndryshme, ndërsa vet njerëzit janë të ndryshëm dhe preferojnë të trajtohen si të tillë. Një gjë është e sigurt: qoftë banka "dixhitale" ose tradicionale, në aspektin e resurseve njerëzore dhe shërbimit, konsultimi me bankierin gjithmonë do të ketë një rol kyç në nivelin e kënaqshmërisë së klientit me shërbimet bankare.





FISNIK LATIFI

ZËVENDËS MENAXHER I TË ARDHURAVE FIKSE TË THESARIT  
RAIFFEISEN BANK KOSOVË

# Koha për bankim investiv në Kosovë

**B**iznesi i bankimit në Kosovë prej që ekziston gjithmonë ka pasur një model të thjeshtë: banka është pika lidhëse mes kursimtarëve dhe huamarrësve, duke pranuar depozitat në bilanc të vete si detyrim, dhe duke regjistruar kreditë e lëshuara si pasuri. Diferenciali i normës së interesit përbën marginën bruto të fitimit. Thjeshtësia e modelit e bëri biznesin të suksesshëm. Por ky lloj i bankimit, bankimi komercial, ballafaqon kufizimet e veta. Kufizimi i parë për bankat është nevoja e kapitalizimit. Nën hijen e Basel 3 dhe se shpejti Basel 4, kërkesat e rikapitalizimit ngriten vetëm tutje, andaj ky kufizim do të theksohet edhe më shumë. Bankat kufizohen në kredidhënie në përgjithësi, por në veçanti edhe me ekspozim të koncentruar. Kufizimi tjetër i bankave, po aq sa i klientëve, është kërkesa për kolateralizim, ku dobia e tyre në rastin e likuidimit është e dyshimtë. Për këtë arsye bankat edhe pse insistojnë në kolateral, lëshojnë kredi me kujdes të shtuar, duke shmangur nevojën e përdorimit të kolateralit. Efekti anësor pozitiv është portfolio me kreditë joperformuese më të ulta në rajon, por realisht bankat kanë hequr dorë nga një pjesë e konsiderueshme të biznesit. Klientët biznesor poashtu kufizohen në afatet e huave jo mjaft të gjata, dhe në mungesë të alternativave të kapitalizimit, çdo udhë të



Banka do të jetë prap vendi ku takohen kursimtarët dhe huamarrësit, mirëpo kësaj radhe ajo do të ketë rolin ndërmjetësues, për çka përfiton nga tarifat dhe komisionet.

çon te banka. Le të bëjmë një kërcim kuantik të zhvillimit, ku bankat që operojnë në Kosovë të pajisen me një biznes model të dytë. Fjala bëhet për bankimin investiv, dhe kjo qasje do të adresojë një sërë të kufizimeve të bankimit tradicional.

Banka do të jetë prap vendi ku takohen kursimtarët dhe huamarrësit, mirëpo kësaj radhe ajo nuk do të jetë kundërpala e biznesit me klientët e saj, por më shumë do të ketë rolin ndërmjetësues. Pra konkretisht do të kemi biznese të etabluara, që kërkojnë kapital nga tregu, dhe i drejtohen bankës për ndihmë. Banka do të hap librin investues dhe do të bëjë përpjekjet e veta për të plotësuar kërkesën e kapitalit duke tërhequr interesimin e investorëve. Aty kursimtarët jokomercial, por poashtu trustet, fondet pensionale e institucionet tjera financiare vendore e ndërkombëtare do të shprehin interesin e tyre duke u nënshkruar në librin investues me shumën dhe çmimin e tyre pjesëmarrës. Ngjashëm me një lloj ankandi, ofertat e dorëzuara do të konkurrojnë me njëra tjetrën për investim. Pas mbylljes së librit investues emetohen letrat me vlerë, qofshin ato ekuitet apo bonde, dhe u distribuohen pjesëmarrësve të suksesshëm në këtë ankand, ndërsa kapitali shkon te biznesi emetues. Banka përfiton nga tarifat dhe komisionet e ndërmjetësimi.



## PSE KY MUND?

Në funksionin e ndërmjetësuesit banka nuk pranon në bilancin e saj depozita, dhe nuk lëshon kredi. Kjo shkarkon bankën nga kërkesa për kapital. Banka mund të realizojë fitim të menjëhershëm, duke mos iu nënshtuar rrezikut kreditor apo rrezikut të ndryshimit të normës së interesit. Në anën tjetër, nëse banka dëshiron të ekspozohet në këtë emetim, ajo mund të bëjë këtë duke mbajtur një porcion të letrave me vlerë në librat e saj. Pra këtu banka mund të kombinojë dy biznes modelet sipas interesit të saj. Biznesi emetues ka gjetur alternativa të kapitalizimit, duke mos u varur vetëm nga oferta e bankës. Çka është më e rëndësishme, kapitali i emetuar nuk kërkon domosdo kolateral, gjë që e shkarkon biznesin prej barrës së ngurtësimit të pasurive të tij. Natyrisht se kjo liri paguhet me një premium në normë të interesit, por së paku biznesi ka në dorë zgjedhjen nëse dëshiron apo jo të ofrojë kolateral.

Një tjetër faktor lehtësues për biznesin është, se potencialisht mund

të merr kapital me kosto më të ultë se përmes bankës, meqë investori kapitalizues tani nuk është një entitet i vetëm që merr përsipër rrezikun kreditor të plotë, por diversifikohet gama e investorëve përmes garës në ankand, ku ofertat më të favorshme për biznesin fitojnë. Në rastin e emetimit të ekuitetit për biznesin paraqitet një mundësi e kapitalizimit virtualisht pa afat të kthimit. Investorët e huaj janë në kërkim të mundësive investive me rrezik mesatar, dhe bizneset kosovare janë shumë të përshtatshme për të: kanë kthim relativisht të lartë, janë të denominuara në euro, dhe kanë një korrelacion të ultë me tregjet globale. Në ambientin me norma të interesit të ulta si tani, tërheqja e tyre do të ishte e realizueshme. Në nivelin makroekonomik investimi në Kosovë do të ketë efekt shumëfishues. Kosova është momentalisht eksportues i kapitalit, jo vetëm me importe të mallrave, por edhe me blerje të letrave me vlerë nga bankat, fondet pensionale dhe investorët privat. Një pjesë e këtij kapitalit mund të investohet brenda ekonomi-

së tonë, duke marrë pjesë në tregun kapital vendor. Këtij tregu i shtohet edhe kapitali i investorëve të huaj, të cilët preferojnë investime në portfolio para investimeve të huaja direkte, për arsye të exit strategjisë së thjeshtësuar. Efekti shumëfishues arrihet kur paraja në ekonominë vendore rrotullon më shumë qarqe, para se të lëjë vendin prap, gjë që ndikon direkt në rritje të bruto produktit vendor.

## A ËSHTË KOSOVA GATI PËR BANKIM INVESTIV?

E kemi treguar që biznes modeli ekzistues, pra bankimi komercial, ballafaqon kufizime, që vështirë se përballohen pa ndryshime të thella në të. Për të mbajtur biznesin ekzistues intakt, kërkohet të aplikohet një biznes model komplementar, i cili adreson keto kufizime, pra bankimi investiv. Edhe pse ky biznes për bankat është i leverdishëm, nuk mund të fillojnë menjëherë operimet. Në mungesë të bazës ligjore, akterët mund të operojnë në përputhje me standardet ndërkombëtare, por asnjëherë nuk janë të mbrojtur nga vendimet gjyqësore arbitrare. Për këtë arsye bankat, si përfituesit primarë të këtij biznesi, këshillohen mirë nëse vetë e marrin përsipër draftimin e një ligji për tregun kapital. Në këtë mënyrë edhe mund të mbrojnë domenën e tyre nga ardhja e akterëve të rinj, për shembull duke vendosur barriera të hyrjes në treg përmes kërkesës për kapitalizim të lartë, sic e kanë bankat.

Si përfundim vlen të theksohet se biznesi i bankimit investiv asnjëherë nuk do të zëvendësojë bankimin komercial, dhe as që duhet synuar. Më tepër duhet shikuar si vegël shtesë në veprimin e bankave, ku ato vendosin në çfarë niveli duan të e shfrytëzojnë atë.



**MSC. ALBERT DEVAJA**  
AUDITOR I BRENDSHËM  
IŞBANK - DEGA NË KOSOVË

# Roli i auditorit të brendshëm në Bankë: Sfidat dhe Mundësitë



**E**kzistimi i funksionit të auditorit të brendshëm në sektorin bankar, ndërlidhet ngushtë me nevojën për të pasur një këndvështrim të pavarur dhe të paanshëm në lidhje me objektivat afatshkurtër dhe afatgjatë të institucionit bankar, punën dhe hapat që ndërmerren për arritjen e tyre, risqet me të cilat përballet institucioni bankar dhe hapësirat e mundshme për keqpërdorime apo mashtrime që mund të ekzistojnë në procesin e arritjes së objektivave të institucionit bankar. Prandaj, në literaturën bankare, funksioni i auditorit të brendshëm klasifikohet si

linja e tretë mbrojtëse e sektorit bankar. Sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, Auditori i Brendshëm duhet të jetë i pavarur nga struktura menaxhuese e institucionit bankar, pra duhet t'i raportojë Komitetit të Auditimit, apo direkt bordit të drejtorëve të institucionit bankar; duhet të jetë i paanshëm (objektiv), puna dhe vendimet e tij/saj nuk duhet të jenë të ndikuara nga faktorët shoqërorë, financiarë apo faktorë tjerë; duhet të jetë kompetent, pra duhet të jetë i përgatitur profesionalisht dhe duhet t'i zotërojë njohuritë e nevoj-

shme për ta ushtruar funksionin e auditorit të brendshëm, duhet të jetë person me integritet, pra duhet ta bëjë punën e tij/saj me përgjegjësi, kujdes dhe me sinqeritet.

Duke pasur parasysh që objektivi kryesor i bankave është të posedojnë sa më shumë aksione dhe përfitime në tregun bankar, ndër qëllimet kryesore të auditorit të brendshëm është të kontribuojë në ngritjen e efikasitetit, funksionimin e kontrolleve të brendshme si dhe përmirësimin e veprimeve operationale të institucionit bankar gjatë arritjes së këtij objektivi.



Por, shpeshherë këto qëllime të auditorit të brendshëm keqkuptohen dhe keqinterpretohen, prej nga edhe rrjedh një hezitim nga i audituari për të ndarë dokumente dhe informata më të detajuara gjatë procesit të auditimit, me arsyetimin se auditori i brendshëm mund të gjejë shkelje të procedurave apo parregullësi të cilat mund të kenë pasoja disiplinore për të audituarin. Përkundrazi, funksioni i auditorit të brendshëm duhet të konsiderohet funksion i cili ndihmon në efikasitetin dhe saktësinë e punës së përditshme të funksioneve tjera bankare dhe në minimizimin e risqeve bankare.

Një ndër parimet kryesore të rolit të auditorit të brendshëm është të qenurit kompetent, pra personi që e ushtron funksionin e auditorit të brendshëm, duhet të ketë njohuri profesionale se si funksionon auditimi i brendshëm. Duke e pasur parasysh që standardet ndërkombëtare, Direktivat e Bashkimit Europian, praktikat ndërkombëtare të sistemit dhe proceseve globale bankare, gjithnjë e më shumë po implementohen në Sektorin Bankar të Republikës së Kosovës përmes legjislationit dhe rregulloreve të Bankës Qendrore të



**Qëllimi i Auditorit të Brendshëm është parandalimi i parregullësive dhe mashtrimeve, jo ndëshkimi i përgjegjësve të tyre!**

Kosovës, është shumë e rëndësishme që personat që e ushtrojnë funksionin e auditorit të brendshëm, të trajnohen dhe të certifikohen paralelisht me zhvillimet më të reja në sektorin bankar ndërkombëtar.

Duhet theksuar se trajnimet, certifikimet dhe seminarët kombëtare dhe ndërkombëtare e ngrisin nivelin e kompetencës së auditorit të brendshëm së një banke, jo vetëm me njohuritë të cilat mësohen nga ligjëruesit, por edhe nga shkëmbimi i përvojave me pjesëmarrësit tjerë në ato organizime. Temat që trajtohen në trajnime/certifikime ndikojnë shumë në ngritjen e vetëdijes, dhe në zgjerimin e njohurive, të cilat e bëjnë auditorin e brendshëm

kompetent në funksionin e tij/saj, prandaj edhe konsiderohet të domosdoshme të ndiqen nga auditorët e brendshëm. Prandaj, këto organizime konsiderohen si mundësi ideale për zhvillimin profesional të auditorit të brendshëm.

Në disa raste, buxheti jo i mjaftueshëm që i ndahet funksionit të auditimit të brendshëm gjatë një viti, konsiderohet si sfidë e madhe për rolin e auditorit të brendshëm. Duke pasur parasysh që risitë, rregullat raportuese dhe zhvillimet tjera bankare në të shumtën e rasteve iniciohen nga shtetet e zhvilluara, mund të thuhet se trajnimet dhe certifikimet më kualitative dhe më aktuale organizohen në po ato shtete, rrjedhimisht edhe shpenzimet e këtyre trajnimeve dhe certifikimeve caktohen sipas standardeve të këtyre shteteve, pra këto shpenzime konsiderohen të jenë të larta, gjë që e pamundësojnë pjesëmarrjen e auditorëve të brendshëm me buxhet të kufizuar.

Duke i pasur parasysh vështirësitë e pjesëmarrjes në trajnime e certifikime në fushën e auditimit të brendshëm, si mundësi alternative mund të konsiderohet bashkëpunimi ndërmjet auditorëve të brendshëm. Zhvillimi profesional i auditorëve të brendshëm mund të bëhet përmes punëtorive, seminarëve apo edhe takimeve të punës të vet auditorëve të brendshëm ku mund të diskutohet për risitë, zhvillimet dhe ndryshimet në sektorin bankar, interpretimin e ligjeve dhe rregulloreve bankare si dhe për problemet, sfidat dhe pengesat në të cilat hasin auditorët e brendshëm si dhe të shkëmbehen përvojat personale gjatë ushtrimit të funksionit të tyre në sektorin bankar.

Si përfundim, qëllimi i auditorit të brendshëm nuk është të ndëshkojë, por të kontribuojë në ruajtjen e aseteve dhe në rritjen e vlerave të institucionit bankar, dhe ky kontribut bëhet edhe më cilësor me zhvillim të vazhdueshëm profesional të auditorit të brendshëm.



**XHEMAJL GASHI**  
SPECIALIST I KONTROLLIT TË RISKUT  
RAIFFEISEN BANK KOSOVË

# Përmbledhje e sektorit bankar dhe sfidat

**T**ë gjitha vlerësimet e institucioneve relevante (FMN, BB, BQK, ASK) të vendit dhe atyre ndërkombëtare konfirmojnë se trajektorja e rritjes ekonomike sillet rreth 3.8 - 4.0 përqind për 2018. Ecuritë në ekonomi të gjysmëvjetorit të parë të vitit 2019 - sinjalizojnë se rritja ekonomike do të mbetet normë njëshifrore edhe për këtë vit. Më tutje edhe projksionet për vitet e ardhshme nuk pasqyrojnë një rritje të dallueshme, lartë mbi këtë të tanishmen. Sidoqoftë kjo rritje cilësohet mjaftë e lartë, por jo e mjaftueshme për një ekonomi me bazë të ulëtë, siq është rasti me ne, për të mundësuar një zvogëlim esencial të papunëve, dhe rritje të fuqishme të sektorit privat, në veqanti atij prodhues për eksport. Aktualisht bilanci tregtar i vendit vazhdon të mbetet tejte i pa-balancuar, dhe në një horizont kohor afatshkurtë nuk pritet të ndryshohet. Eksporti arrinë të mbuloj rreth 12 përqind të importit. Kjo rritje e ekonomisë është e nxitur nga konsumi i brendshëm, i cili financohet kryesisht nga remitencat, dhe ato vazhdojnë të mbesin një kontributor i rëndësishëm në BPV e vendit. Më domethënëse do të ishte sikur rritja ekonomike të vijë si kontribut i eksportit.

SEKTORI BANKAR I VENDIT,  
DOMINOHEM Nga PËRBËRJA  
E KAPITALIT TË HUAJ, E CILA  
ARRINË SHKALLËN

86.8 %

DHE PJESA TJETËR E MBETUR,  
KAPITAL VENDOR.

NGA  
10  
BANKA


SA OPEROJNË NË VEND

8  
NGA ATO JANË NË  
PRONËSI TË HUAJ.

Viti 2018 është mbyllë me inflacion në shkallë 1.1 përqind, ndërsa matjet për gusht 2019 pasqyrojnë një rritje të cmimeve në shkallë 2.6 përqind kundrejtë të njëjtit muaj të vitit të shkuar. Në të vërtetë inflacioni në Kosovë cilësohet si inflacion i importuar nga fakti se importi përbën pjesën dërmuese të mallrave dhe shërbimeve për konsum në vend. Kjo ngritje e theksuar e cmimeve është shkakuar pothuaj nga vendosja e taksës 100 përqind për importet me origjinë nga vendi fqinjë verior.

**Sektori bankar i vendit**, dominohet nga përbërja e kapitalit të huaj, e cila arrinë shkallën 86.8 përqind dhe pjesa tjetër e mbetur, kapital vendor. Nga 10 banka sa operojnë në vend 8 nga ato janë në pronësi të huaj. Sektori bankar i themeluar në vend ka një shtrirje të gjërë dhe kompakte me gjithsej 217 njësi operuese, në të cilat janë të punësuar 3297 persona. Kapitali i huaj i cili e karakterizon sektorin bankar të vendit përbën një avantazh e poashtu është një potencial në dispozicion për të mbështetur në perspektivë ngritjen e pritshme të sektorit privat në vend. Për më tepër këto banka janë pjesë e grupeve të bankave respektive,

## Indikatorët e profitabilitetit



gëzojnë avantazhet kundrejt bankave të tjera të vogla, kanë kosto më të ulët, janë më profitabile, përfitojnë në emrin e brendit, kapital human më të avancuar, dhe janë me mundësi më të mëdha për përshtatje ndaj ndryshimeve që ndodhin në industrinë financiare.

Sektori bankar i vendit cilësohet si mjaftë profitabil, financiarisht i shëndetshëm, mirë i kapitalizuar, dhe likuid. Viti i shkuar është mbyllë me 88 mil. euro profit, ndërsa deri në gusht të 2019 - profiti arrinë vlerën 58.5 mil. euro. Norma e kthimit mesatar (ROAA) në asete është 2.1 përqind kurse ajo e kthimit në kapital (ROAE) 17.5 përqind. Norma e likuiditetit është 37 përqind ndërsa Tier1 & Tier2 përbën 17 përqind të mjeteve të peshuara me rrezik (RWA). Në anën tjetër, kreditë joperformuese vlerësohen më të ulëta në regjion, dhe sipas të dhënave të shtatorit 2019 - ato janë rreth 2.2 përqind. Për më tepër ato janë të mbuluara mirë me provizione, dhe norma e mbulimit është mjaftë e lartë, rreth 164 përqind.

Asetet kanë shënuar rritje të vazhdueshme, dhe vlera e tyre deri në gusht të (2019) këtij viti arrinë në 4,464.5 mil. euro. Nga kjo, stoku i kredive kapë shumën 2,942.9 mil. euro (norma vje-

toe e rritjes 10.4). Rritja e kredive është përcjellë me rënie të lakores të normës efektive të interes, e cila tani është 6.4 përqind. Depozitat kanë arritur shumën 3,617 milion (rritje vjetore prej 11.9 përqind). Nga ato depozita të ekonomive familjare janë 2,500.8 mil. euro, ndërsa pjesa tjetër prej 638.1 i takon ndërmarrjeve.

### SFIDAT E SEKTORIT BANKAR NË KOSOVË

Tani sektori bankar konfrontohet me vështirësi të cilat dalin nga rritja komplekse e ambientit rregullativ në vend, presionit në kostot e operimit, dhe përpjekjeve të shtuara për të mbajtur të qëndrueshme trajektoren e rritjes. Sa më tepër që konkurrenca vazhdon të rritet më shumë mundësi përfituese, vihen në dispozicion të konsumatorit. Konsumatorët parapëlqejnë qasje të lehtë, dhe përdorim të shërbimeve elektronike. Prandaj bankat janë të shtyera të transformohen duke lëshuar modelin tipik tradicional, dhe kalim gradual në një model që ofron shërbime me bazë të teknologjisë elektronike të avancuar. Ndaj në rrugën e transformimit të tyre ballafaqohen me sfida komplekse.

## 1 PËRDORIMI I KANALEVE TË SHUMTA NË KËRKIM TË KLIENTËVE TË RINJË

Presioni në rritje për të gjetur klientin e ri, po i shtynë bankat të bëhen më shumë inovative në strategjinë e kreditimit të tyre. Në njërin anë ato konfrontohen me peripetitë për të mbajtur partneritet të qëndrueshëm me klientët ekzistues, në anën tjetër ballafaqohen me sfidën për të takuar klientët e rinjë, dhe përfituar ata. Për të arritur këtë, ato duhet të përdorin marketing përmes kanaleve të shumta si ai tradicional, digjital, media sociale (chat box). Por para se ta bëjnë këtë ato duhet të bëjnë analiza të thella të të dhënave për klientët të cilët i targetojnë dhe të shpenzojnë marketing në masë të nevojshme për t'i tërhequr ata, dhe të sigurohen se euro e investuar do të arrijë kthimin më të mirë.

## 2 BANKË E ORIENTUAR PËR SHËRBIME TË LIRA PËR KONSUMATORËT

Shërbimet miqësore, është moto dhe në të njëjtën kohë është edhe sfida për secilen bankë moderne. Aplikacionet portale, shërbimet bankare online kursejnë kohën e konsumatorëve, ndërsa bankës i sjellin kursime në para. Për

ndryshe qasja tradicionale është më e kushtueshme. Qëllimi i përdorimit dhe aplikimi të të gjitha këtyre përparimeve është për të tërhequr konsumatorët, dhe të zgjidhë sfidën respektive.

### 3 RREGULLATORI

Kërkesat e rregullatorit në vijësi rriten, dhe bankat nevojiten të shpenzojnë një pjesë nga bugjeti i tyre për të qenë në pajtueshmëri me dinamikën e kërkesave që dalin nga ai. Ato vazhdimisht duhet të vlerësojnë, dhe përmirësojnë operimin e tyre për tu siguru se janë në pajtueshmëri me rregullatorin. Ngarkesat (fee, charge), provizionet, baza e kapitalit, janë kërkesa që derivojnë nga autoriteti rregullativ. Kjo është kundërvlera për të siguruar në vend një sistem bankar të qëndrueshëm, dhe të aftë për t'i përballuar tundjeve që besohet se mund të ndodhin. Këtu duhet shtuar implementimin e direktivave të Komitetit të Basel-it. Dhe krejtë në fund, domosdoja për të harmonizuar sistemin bankar të vendit dhe fillimit të futjes në procesin e integritetit dhe të unifikimit me sistemin bankar europian.

### 4 ÇËSHTJET PRONËSORE-INFORMALITETI

Pasuria e paluejtshme në prizmin e industrisë financiare shiqohet si një kontributor, në veqanti në drejtim të kredive hipotekare. Në vend është i instaluar një sistem kadastral modern, roli i të cilit është menagjimi dhe administrimi i pasurive të paluajtshme dhe tokës. Mirëpo, gjendja reale përmbanë probleme komplekse të trashëguara në njërin anë por edhe të krijuara së fundmi nga mungesa e një vizioni dhe strategjie për të dhënë zgjidhjen më të mirë. Vlerësohet se shumica dërrmuese e sektorit të paluejtshmërive është e pa-legalizuar. Kjo kufizon rritjen e financimit apo të kredidhënies sidomos kur është fjala për kreditë hipotekare, dhe njëkohësisht përbënë një barrierë për rritje ekonomike. Ekonomistët konsiderojnë se

VITI I SHKUAR ËSHTË MBYLLË ME

# 88mil

EURO PROFIT,

NDËRSA DERI NË GUSHT TË 2019 - PROFITI ARRINË VLERËN

# 58.5mil

EURO

sektori financiar është forcë shtytëse e rritjes së ekonomisë. Prandaj cdo pengesë, redukton kapacitetin e saj për një rritje më të përshpejtuar të ekonomisë.

### 5 GJYQËSORI DHE FUQIZIMI I KONTRATËS

Sistemi i drejtësisë përmban ligje të mira por aspekti i funksionalizimit çalon. Ka një numër të konsiderueshëm të lëndëve të prapambetura me vite të tëra. Kjo për shkak të joefiqencës, mungesës së kompetencës dhe llogaridhënies. Në kohët e fundit është shënuar progres i theksuar në fuqizimin e kontratës por ka ende shumë hapsirë për përmirësim. Zgjidhje do të ishte formimi i një dhome-gjykatë të posaqme për të trajtuar lëndët e sektorit bankar. Kjo do të përmirësonte esencialisht pozitën konkurruese të sektorit bankar në kontekstin e gjere.

### 6 EKONOMIA JOFORMALE

Vlerësohet se rreth 30 përqind e ekonomisë së vendit bie në fushën e informalitetit. Shumë biznese mbajnë kontabilitet paralel, një për qëllime fiskale, dhe tjetrin për ate vetanake. Publikimi i pasqyrave financiare dhe auditimi i tyre ende është në fazën fillestare. Kjo paraqet një vështirësi për bankat, analizat e bankave duhet të bëjnë më shumë

analiza për të konfirmuar vërtetësinë e pasqyrave financiare, dhe kjo merr më shumë kohë dhe efektin koston.

### 7 RITJA E VAZHDUESHME E TEKNOLOGJISË-FINTECH

FinTech, është prurje e re në shërbimet financiare. Rritja rapide dhe zgjerimi i përdorimit të tyre po ndërron afarizmin e bankave anë e kënd botës, dhe ne nuk mbetemi të përjashtuar nga ky evolucion. FinTech po bëhet pjesë integrale e bankave, dhe tani bankat kanë filluar të konkurrohen edhe nga sektori jo-financiar si për shembull në shërbimet e pagesave, shërbime të cilat tradicionalisht ato i kanë ofruar. Për më tepër FinTech po shtrihet në të gjitha shërbimet financiare. Avansimet e fundit në teknologji, kërkojnë që bankat të rrisin investimet e tyre në FinTech. Disa e shofin FinTech si një kërcënim ndaj shërbimeve tradicionale të bankave kurse të tjerët e shofin këtë si një mundësi, sepse ofrojnë më shumë fleksibilitet, funksionalizim më të mire dhe agregim të shërbimeve. Ndaj bankat po sforcojnë pozitën e tyre të riskut, rrespektivisht reduktojnë riskun përmes shoqërimit dhe përcjelljes të zhvillimeve në FinTech.

### KONKLUZIONI

Sektori bankar në vend është rritur konsiderueshëm. Aftësia kredituese e saj është shtuar dukshëm, nga këndvështrimi i fitimit mbetet majtë atraktive, ka arritë të demostrojë rritje të qëndrueshme, dhe të mbajë nivel adekuat të bazës së kapitalit. Bankat duhet të përshtaten ndryshimeve, biznes modelin e tyre, të diversifikojnë të hyrat e tyre, dhe reduktojnë kostot e inefiqencës. Duhet të përgatiten të ballafaqohen me sfidat e digjitalizimit, konkurrencës, reduktimit të kostove, të sigurohen të operojnë në pajtueshmëri me rregullatorin, dhe përgatiten të për fazën iniciale të procesit të harmonizimit dhe integritetit me sistemin bankar europian.



**KATERINA BOSEVSKA**  
DREJTORE MENAXHUESE  
EOS MATRIX - MAQEDONI DHE KOSOVË

# Efektet e kombinuara të përcaktuesve makroekonomikë dhe specifike sipas bankave për NPL-të



NPL-të janë një nga treguesit bazë të shëndetit financiar të bankave dhe përbëjnë masën kryesore të riskut kreditor në sistemin bankar.

Kur një numër subjektsh ekonomike kanë vështirësi me shlyerjen e borxhit të tyre, ne konsiderojmë rritjen e probabilitetit që huat nuk do të lahen (moskthim i kredisë).

Vlera e aktiveve të bankës bie dhe pasuria e saj zvogëlohet si rezultat i

humbjeve të pësuarra për shkak të anulimeve (fshirjes nga bilanci). Duke pasur parasysh që bankat nuk funksionojnë në mënyrë të pavarur dhe veçmas nga njëra-tjetra, por ato ndërthuren dhe operojnë me linja të shumta në prapavijë, performanca e dobët e një banke mund të përhapet lehtësisht në të gjithë sektorin bankar dhe të shkaktojë paqëndrueshmëri dhe stres financiar. Në rastin më të keq, cilësia e përkeq-

ësuar e huave në sektorin bankar krijon kërcënim nga risku sistemik, panik dhe flukse dalëse të depozitave, kufizime të ndërmjetësimit financiar, dhe në fund të fundit kufizime në investime dhe rritje. Përvoja ka treguar që rritja e kredive jo-performuese luan rol kyç në shfaqjen e krizave bankare. (Kunt & Detragiache, 1988; Gonzales-Hermosillo, 1999). Duke marrë parasysh sa u tha më lart, çështja e kredive jo-performuese, së bashku me faktorët nga të cilët varen dhe efekti i tyre në ekonominë reale, u bë shqetësim kryesor i pothuajse të gjitha vendeve në botë dhe zgjidhja e kësaj çështjeje u bë parakusht për rivendosjen e funksionalitetit të tregjeve financiare (Klein 2013).

Studimi i përcaktuesve të NPL-ve dhe ndikimi i tyre ka fituar në rëndësi në vitet e fundit, veçanërisht pas krizës financiare të 2007-2008. Ca analiza diagnostikuese bazuar në marrëdhëniet afatgjata dhe vlerësimet e dinamikës afatshkurtër tregojnë se janë disa lidhje midis mjedisit makroekonomik, përcaktuesve bankarë dhe kredive jo-performuese. Duke dalë nga vetë analizat, përcaktuesit e NPL-ve mund të klasifikohen si specifike sipas bankës dhe makroekonomikë. Të dy përcaktuesit e NPL-ve kanë ndikim në vëllimin e



NPL-ve si për ndërmarrjet ashtu edhe për ekonomitë familjare.

Përcaktuesit specifikë sipas bankës, siç janë rentabiliteti, rritja e kreditimit dhe mjaftueshmëria e kapitalit-aftësia paguese, kanë ndikim të kufizuar në kreditë jo-performuese varësisht nga përcaktuesi. Për shembull, rentabiliteti i shprehur përmes kthimit nga aktivet (ROA), me rezultatet empirike të Louzis në al. (2010) konfirmon ndikimin negativ dhe domethënës nga aspekti statistikor, d.m.th. bankat më pak fitimprurëse kanë tendencë të ndërmarrin risk më të lartë kreditor që çon në ekspozim të rritur ndaj riskut të kredive jo-performuese ndërsa bankat përpiqen me ngut të kompensojnë nën-performancën. Rritja e kreditimit ka ndikim negativ dhe pothuajse nuk ka ndikim në NPL nën supozimin se kur japin kredi të reja bankat veprojnë me kujdes të shtuar. Pjesa e kapitalit në totalin e aktiveve e shprehur përmes raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, ose aftësisë paguese tregojnë ndikim pozitiv dhe domethënës nga aspekti statistikor vetëm për NPL-të për ndërmarrjet meqë lejon rritjen e kapacitetit të bankave për të pranuar risk më të lartë, që nga ana tjetër ndikon negativisht në cilësinë e portofolit kreditor.

Përcaktuesit makroekonomikë si rritja e PBB-së, shkalla e papunësisë, kursi real i këmbimit, inflacioni gjithashtu tregojnë ndikim të ndryshëm. Për shembull, rritja e PBB ka raport negativ. Ngritja e rritjes ekonomike zvogëlon riskun kreditor (p.sh. NPL-të). Shkalla e papunësisë ka ndikim pozitiv dhe domethënës nga aspekti statistikor për NPL-të, meqë rritja e papunësisë rezulton në rënie të kërkesës efektive që prek prodhimin dhe ulja e prodhimit redukton të ardhurat për ndërmarrjet ose reduktimi i parave të gatshme për ekonomitë familjare ndikon në kapacitetet e tyre për të përmbushur detyrimet e tyre. Kursi real i këmbimit ka ndikim domethënës vetëm te NPL-të për ndërm-

NË VITIN 2013 RAPORTI MESATAR  
PËR NPL NË EVROPË ISHTE NË  
SHKALLË PREJ

6.4%

NË SHBA

2.5%

NË JAPONI

2.1%

QË ËSHTË MESATARE MË E LARTË  
PËR RRETH

60%

EDHE PSE NË 3 VITET VIJUESE  
PATI TREND NË RËNIE TË  
RAPORTEVE MESATARE, PRAPË  
NË BE RAPORTI MESATAR PËR  
NPL NË SHKALLË PREJ

3.7%

ISHTE PËRAFËRSISHT

67%

MË I LARTË SE AI NË SHBA DHE  
JAPONI NË SHKALLËN

1.2%

arrjet, gjegjësisht për shkak të tendencave të prishme negative në sektorin real në rast të devalvimit të monedhës. Inflacioni u dëshmuar të jetë përcaktues domethënës nga aspekti statistikor me dinamikë afatshkurtër për NPL-të që vijnë nga ekonomitë familjet për shkak të faktit se rritja e normave të inflacionit ul vlerën reale të borxhit.

Çka mund të shihet nga të dhënat në dispozicion në Bankën Botërore dhe FMN, edhe pse ekziston trendi i përgjithshëm i rënies së raportit të NPL-ve, BE ka raporte mesatare më të larta se SHBA dhe Japonia. Për shembull: në vitin 2013 raporti mesatar për NPL në Evropë ishte në shkallë prej 6.4%, në SHBA 2.5% dhe 2.1% në Japoni që është mesatare më e lartë për rreth 60%. Edhe pse në 3 vitet vijuese pati trend në rënie të raporteve mesatare, prapë në BE raporti mesatar për NPL në shkallë prej 3.7% ishte përafërsisht 67% më i lartë se ai në SHBA dhe Japoni në shkallën 1.2%.

Kontribut të madh në trendin e rënies së vëllimeve të NPL-ve jep rregullimi bankar në fuqi që mund të karakterizohet si valë të njëpasnjëshme të derregullimit dhe politikave më të rrepta pas periudhës së krizave.

Iniciativat e fundit rregullatore po ndihmojnë në krijimin e sistemit të qëndrueshëm të zgjidhjes së NPL-ve brenda BE-së. Mbikëqyrja rregullatore dhe korniza e tregut kërkojnë qasje strategjike dhe proaktive në menaxhimin e portofoleve kreditore që duhet të çojnë në raport më të ulët të NPL-ve. Ndryshimet nga menaxhimi tipik i portofolit kreditor në Menaxhimin e Portofolit të Kredive Aktive (ACPM) rezultojnë nga prezantimi i rregullës së IFRS 9 që kërkon qysh në fazë shumë të hershme menaxhim aktiv dhe të orientuar drejt tregut për portofolin kreditor, në mënyrë që të shmangët provizionimi dhe paqëndrueshmëria e fitimit dhe humbjes dhe ulja e përhershmërisë së ekspozimeve jo-performuese në li-



Mbikëqyrja rregullatore dhe korniza e tregut kërkojnë qasje strategjike dhe proaktive në menaxhimin e portofoleve kreditore që duhet të çojnë në raport më të ulët të NPL-ve

brat e bankave. Udhëzimi rregullator, mbulesat e kujdesshme dhe SNRF 9 do të ulin vlerën e aktiveve problematike në bilancet e bankave dhe do t'i shtyjë tutje bankat që të shesin dhe të anulojnë stokun e tyre të NPL-ve. Nga 1 prill 2018 e tutje, për NPL-të e reja është i nevojshëm provizionimi i kujdesshëm i plotë pas 7 vjet për aktivet e siguruara dhe pas 2 vjet për asetet e pasiguruara. Rritja e provizioneve për aplikimin fillestar të IFRS 9, duke marrë parasysh të dhënat e mbikëqyrjes të raportuara nga 53 banka, arrin në mesatare të thjeshtë prej 9%. Është e rëndësishme të theksohet se rezultatet e raportuara nuk tregojnë trendet ose lëvizjet e ardhshme në këto numra. Alokimi i instrumenteve financiare për kategoritë e ndryshme sipas IFRS 9 çon në ndikim për shkak të ndryshimeve në matjen e atyre numrave. Tani tre kategori në vend të katër kategorive sipas SNK 39. Rritja e provizioneve lidhet kryesisht me aktivet financiare që performojnë (aktivet në fazën 1 ose 2) për të cilat provizionet u rritën në mesatare të thjeshtë prej 94%. Rritja e lartë është për shkak të stokut të vogël fillestar të provizioneve për aktivet që performojnë sipas kërkesave të SNK 39, dhe është në përputhje me efektet e parashikuara të standardit të ri (adresimi i disa prej kritikave të modelit të mëparshëm. Bankave u kërkohet të informojnë Bankën Qendrore Evropiane për çdo ndryshim midis praktikave

të tyre dhe pritjeve të provizionimit të kujdesit, si pjesë e dialogut mbikëqyrës të SREP, ndërsa zbatimi i detyruar dhe pasojat janë të kufizuara. Duke ndjekur udhëzimet e fundit të EBA për menaxhimin e ekspozimeve jo-performuese dhe ekspozimeve nga të cilat është hequr dorë nga 30 qershori 2019 që aplikohen për të gjitha institucionet e rreguluara kreditore në Evropë, bankat e BE-së me raporte NPL bruto më të mëdha se 5% pritet të krijojnë strategji për NPL si pjesë e strategjisë së tyre të përgjithshme dhe të zbatojnë aranzhime të fuqishme të qeverisjes dhe operacioneve.

Përveç rregullës së IFRS 9, rregullimi i ri dhe pritjet mbikëqyrëse paraqesin sfida të reja për kërkesat e kapitalit të bankave, që do të thotë, përmirësim të saktësisë së kapitalit si në nivelin teknik ashtu edhe në atë të biznesit. Këshilli i BE-së në prill 2019 adoptoi reformën për të imponuar kërkesa të kapitalit për kreditë jo-performuese të bankave. Reforma prezanton mbulesën e kujdesshme për NPL-të e reja në bilancet e bankave, që nënkupton mbulimin e zakonshëm të humbjeve minimale për shumën e parave që bankat duhet të lënë mënjanë për të mbuluar humbjet e shkaktuara nga kreditë e ardhshme që do të shndërrohen në jo-performuese, me faktin se kreditë që janë me 90 ditë vonesë klasifikohen si NPL. Kërkesa të ndryshme të mbulimit do të zbatohen varësisht nga klasifikimi i NPL-ve si aktive të pasiguruara apo të siguruara dhe nëse kolaterali është i luajtshëm ose i paluajtshëm.

Presioni rregullator dhe mbikëqyrës ka tendencë të motivojë bankat për të trajtuar barrën e tyre të NPL-ve, që lehtëson menaxhimin aktiv të bilancit. Udhëzimet dhe mbulesat e kujdesshme nga institucionet e BE-së, si dhe IFRS 9 do të kontribuojnë në aktivitetin e tregut të NPL-ve në shumë vende në rajonin e EQL-së. Reforma nga Këshilli i BE-së përcakton kërkesa të repta të

kapitalit për bankat, ndërsa ndikimi i udhëzimeve të mëparshme nga ECB dhe EBA është i kufizuar.

Mbikëqyrja rregullatore dhe korniza e tregut kërkojnë qasje strategjike dhe proaktive në menaxhimin e portofoleve kreditore. Ndryshimet nga menaxhimi tipik i portofolit kreditor kryesisht janë për shkak të faktit se IFRS 9 kërkon qysh në fazë shumë të hershme menaxhim aktiv dhe të orientuar drejt tregut për portofolin kreditor, në mënyrë që të shmanget provizionimi dhe paqëndrueshmëria e fitimit dhe insistimi i vazhdueshëm për ulje të përhershmerisë së ekspozimeve jo-performuese në librat e bankave.

### BANKA QENDRORE EVROPIANE U KËRKON BANKAVE TË PËRKUFIZOJNË "STRATEGJI REALISTE DHE AMBICIOZE" PËR MENAXHIM TË NPL-VE. STRATEGJIA E SHËNDOSHË PËR MENAXHIM TË NPL-VE DUHET TË NDËRTOHET MBI 3 SHTRESA TË ANALIZËS


- Analiza e bilancit të gjendjes
- Analiza e vlerës (Ilogaritja e EVA)
- Ndikimet e kapitalit

Analiza e bazuar në bilanc konsiderohet të jetë qasje e pjesshme - pa perspektivë largpamëse, sepse nuk përfshin disa zëra siç është kompensimi i kapitalit. Analiza ekonomike dhe e kapitalit duhet të jetë komponent në vlerësimin e transaksioneve dhe procesin e vendimmarrjes që duhet të vihen në kornizën e strategjisë së përgjithshme të menaxhimit të NPL-ve.

Shumica e vendeve të Evropës Lindore kanë parë zhvillim të zbehtë në vëllimet e NPL-ve me rënie totale prej 7% që rezultojnë nga aktivitetet e tyre të shitjes së borxheve si përgjigje ndaj nevojës për trajtim të shpejtë dhe dinamik të NPL-ve.


# SEKTORI BANKAR NË SHIFRA

**216**  
NUMRI I NJËSIVE  
BANKARE



**494**  
NUMRI I ATM-VE

**13,637**  
NUMRI I POS-AVE



**292,318**  
NUMRI I LLOGARIVE E-BANKING

**1,271,379**  
NUMRI I KARTELAVE BANKARE



**3,295**  
NUMRI I TË PUNËSUARVE

2019

# Mbahet takimi konsultativ për vlerësimin e sektorit financiar (FSAP)



18.06.2019, **Prishtinë** - Kryeshefi Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK), Ztr. Petrit Balija, i shoqëruar nga Ztr. Kreshnik Kosumi, Zyrtar i Lartë për Operacione, priten sot në takim

delegacionin e Bankës Botërore të përbërë nga: Ztr. Nadeem M. Karmali, Zyrtarë i Lartë për fushën e Ekonomisë, Ztr. Will Paterson, Specialist i Sektorit Financiar, Znj. Natalie Nicolaou, Specia-

liste e Sektorit Financiar dhe Ztr. Diego Sourrouille, Analist i Sektorit Financiar, të cilët po qëndrojnë në vizitë zyrtare në Kosovë, me ç'rast do të bëjnë vlerësimin e sektorit financiar (FSAP), me fokus të

## Kryeshefi ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës pritet në takim zyrtar nga përfaqësuesit e European Banking Training Network (EBTN)



13.08.2019, **Bruksel** - Kryeshefi Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balija është pritur në takim zyrtar në Bruksel nga përfaqësuesit e European Banking Training Network (EBTN), Z. Colin Morrison, President i EBTN dhe Znj. Felicia Emery, Menaxhere Ekzekutive në

veçantë aspektet zhvillimore të sistemit financiar, sistemin e pagesave dhe potencialin e financimit në Kosovë. Në këtë takim morrën pjesë edhe përfaqësues të sektorit bankar si Znj. Suzan Dervari, Nënkyetare e Komitetit të Pajtueshmërisë dhe Znj. Vlora Osmani, Kryetare e Komitetit Ligjor në kuadër të SHBK-së. Përgjatë këtij takimi, ndër të tjera, u diskutua për praktikatat dhe të drejtat e kreditorit/debitorit, krijimin dhe regjistrimin e transaksioneve të sigurt, zbatimin e borxhit dhe rimarrjen e kredisë, procedurat e falimentimit, përshtatshmërinë e reformave ligjore dhe zbatimin institucional.

Kryeshefi Ekzekutiv i SHBK-së, Ztr. Balija informoi të pranishmit me gjendjen aktuale të sektorit financiar në Kosovë dhe sfidat e sektorit bankar në të bërit biznes karshi vështirësive në marrjen e kolateralit. Gjithashtu, u tha se zbatimi i ligjit dhe efikasiteti i përmbuesve privat ka ndikuar në përmirësimin e përmbushjes së obligimeve ligjore kontraktuale mes palëve. Në këtë takim, krahas diskutimit për sfidat dhe barrierat e sektorit financiar u theksua potenciali zhvillimor që sektori bankar ofron në Kosovë.

EBTN. Gjatë këtij takimi u diskutuan mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit në mes të Akademisë Bankare të SHBK-së dhe EBTN-it, për të rritur mundësitë e përfitimit të njohurive për bankierët në Kosovë përmes avansimit të programeve trajnuese sipas programeve të akredituara evropiane. Trendet në arenën evropiane të avancimit të punonjësve dhe ngritjes profesionale përmes trajnimeve, kanë bërë që edhe kuadri profesional i Bankave në Kosovë të jetë me një linjë të barabartë, duke përmbushur kështu edhe standardet evropiane përmes certifikimeve ndërkombëtare.

## Anëtarët e SHBK-së morrën pjesë në programin: “Executive Program-a Strategic Bank Management Review” të mbajtur në Luksemburg



24.06.2019, **Luksemburg**

Përfaqësuesit e anëtarëve të Shoqatës së Bankave të Kosovës, pas qëndrimit katër (4) ditor në Luksemburg, vlerësuan lartë programin “Executive Program-A Strategic Bank Management Review”, ngjarje e rëndësishme së veçantë në sektorin bankar, ku pjesëmarrës ishin Menaxhmenti i lartë i Bankave nga Evropa, duke përfshirë edhe Kosovën, me ç’rast sektori ynë bankar u përfaqësua nga: Znj. Arta Shporta, Udhëheqëse e Menaxhimit të Riskut të Kredisë, Raiffeisen Bank Kosovo dhe Ztr. Agon Skeja, Udhëheqës i Financave dhe Administratës, Banka Kombëtare Tregtare. Përgjatë qëndrimit në Luksemburg, pjesëmarrësit

patën rastin që krahas ligjëratave, pjesëmarrjes në panele të diskutimeve dhe vizitave të institucioneve financiare, të takohen edhe me udhëheqësit e bankave, me të cilët shkëmbyen përvojat nga fusha e sektorit bankar. Shoqata e Bankave të Kosovës, në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm, është e përkushtuar në vazhdimësi të ofrojë mundësinë e pjesëmarrjes për anëtarët e saj, në ngjarje të tilla, të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të individëve. Executive Program u organizuar nga House of Training në bashkëpunim me Qeverinë e Luksemburgut dhe ATTF

# Implementimi i IFRS 9 dhe i rregulloreve tjera të reja




06.09.2019, **Prishtinë** - "Sektori bankar në Kosovë ka treguar sukses në procesin e zbatimit të standardeve ndërkombëtare të Baselit dhe IFRS 9, ndërsa Banka Qendrore e Kosovës është duke përbushur

praktikat më të mira ndërkombëtare për të mundësuar funksionim të mirëfilltë të sektorit bankar në Kosovë përmes rregullativës financiare". Kështu u tha në punëtorinë një ditore e cila u organizua

nga Shoqata e Bankave të Kosovës në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës, e që bëri bashkë përfaqësuesit e sektorit bankar dhe atij të BQK-së për të diskutuar rreth sfidave, mundësive dhe efekteve të implementimit të IFRS 9 nga sektori bankar në Kosovë. Në kuadër të kësaj punëtorie, ndër pikat më të rëndësishme të diskutimit ishin: Raportimi në Regjistrin Kreditor - vlerësimi i klientëve sipas nivelit/ratingut (modele të IFRS 9) apo sipas standardeve ekzistuese të BQK-së; Efekti i IFRS 9 në aspektin tatarimor; Sqarimet në lidhje me modelet sipas IFRS 9 për portfolio kreditore apo produktet e reja; Validimi i modeleve të IFRS 9 dhe sqarimet në lidhje me modelet makro-ekonomike. Tutje u tha se Kosova ka dëshmuar gatishmërinë për të ecur para përmes implementimit të IFRS 9, përkundër faktit se ky proces është mjaft sfidues.

## Sektori Privat në Kosovë do të përfitoj nga Financimi Bankar përmes Faktoringut



12.09.2019, **Prishtinë**  
Sot, u mbajt punëtorinë "Faktoringu si një mjet alternativë për financimin e NVM-ve në Kosovë", ku e ftuar ishte edhe Shoqata e Bankave të Kosovës, si përfaqësuese e sektorit bankar në Kosovë. Të ftuar për fjalë hyrëse në këtë ngjarje ishin: Kreu i Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Kosovë, Z. Neil Taylor, Zëvendës Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës,

Z. Sokol Havolli dhe Kryeshefi i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Z. Petrit Balija. Në fjalën e tij hyrëse, Kryeshefi i SHBK-së, Z. Balija tha se "Faktoringu si instrument ka hapur një etap të re në sektorin privatë në Kosovë ndërsa janë bizneset ato të cilat kanë përfituar drejtpërsëdrejti nga mundësitë e favorshme që u janë vënë në dispozicion, duke u mundësuar që të kursejnë kohën dhe të realizojnë transa-

ksione në kohë reale për të mundësuar operim të rrjedhshëm të biznesit." Tutje, Z. Balija potencoi se Shoqata e Bankave të Kosovës ka qenë e kyqur që nga fillimi i iniciativës për zhvillimin e faktoringut në Kosovë ndërsa tha se SHBK do të jetë partnerë në zbatimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve që do të rezultojnë nga punëtoria. Kjo punëtori, bëri bashkë drejtues të institucioneve publiko-private, të cilët përgjatë diskutimeve, prezantuan avantazhet, shembuj praktik dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, të cilat u morën në konsideratë gjatë procesit të draftimit të rregullores aktuale të Faktoringut, e që është në fuqi që nga Nëntori i 2018-tës. Në fund, pjesëmarrësit e punëtorisë analizuan sfidat aktuale të ofrimit të këtij instrumenti në Kosovë ndërsa u potencua se zhvillimet e fundit teknologjike kanë pasur rol të rëndësishëm në avancimin e këtij shërbimi, duke bërë mjaft atraktiv për bizneset.



## Shoqata e Bankave të Kosovës përkrah themelimin e Gjykatës Komerciale në Kosovë

10.09.2019, **Prishtinë** - Kryeshefi Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Z. Petrit Balijsa priti në takim zyrtar përfaqësueset e programit të USAID për Drejtësi Komerciale, Znj. Vjosa Shkodra, Zëvendës Drejtoresh e Programit dhe Znj. Njomëza Zejnullahu, Këshilltare e Lartë Ligjore. Në këtë takim morën pjesë edhe Kryetarja e Komitetit Ligjor, Znj. Vlora Osmani dhe Zyrtari i Lartë për Operacione, Z. Kreshnik Kosumi ndërkaq u diskutua për Programin e Drejtësisë Komerciale (Commercial Justice Activity), i cili për qëllim ka themelimin e Gjykatës Komerciale, reduktimin e mundësive për korrupsion duke ndihmuar në përdorimin e metodave alternative të zgjidhjes së kontesteve komerciale, përmirësimin e ambientit në të bërit biznes dhe zbatimin e vendimeve të gjyqësorit. Programi në fjalë përbëhet nga dy komponenta, ku në komponentin e parë, programi punon me qëllim përmirësimin e cilësisë së drejtësisë komerciale, duke u përqendruar në reformat që do të zvo-

gelojnë mundësitë për korrupsion, do të rregullojnë rrjedhën e duhur të lëndëve dhe do të përmirësojnë kapacitetin e gjykatave mbi të drejtën dhe procedurën komerciale, duke përfshirë trajnime për gjyqtarët, bashkëpunëtorët profesional, stafi i gjykatës dhe palët e tjera të interesuara ndërkaq në komponentin e dytë, për të rritur përdorimin e metodave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, të sigurojë që ligjet komerciale janë në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe praktikën më të mira ndërkombëtare, dhe të përmirësojnë vetëdijen e publikut për kontestet tregtare dhe mekanizmat e zbatimit.

Gjatë këtij takimi, Z. Balijsa tha se themelimi dhe funksionalizimi i një gjykate komerciale në Kosovë është prioritet i rëndësishëm së veçantë edhe për sektorin bankar prandaj SHBK përkrahë këto zhvillime të cilat mund të përmirësojnë infrastrukturën ligjore dhe zbatimin e ligjit dhe kontratave e që janë në një frymë me praktikën më të mira evropiane. Ndërkaq, Znj. Shkodra potencoi

se Programi për Drejtësi Komerciale është duke mbështetur iniciativën për krijimin e Gjykatës Komerciale si dhe duke ofruar edhe asistencë teknike për të përmirësuar efikasitetin në departamentin ekonomik të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Ajo gjithashtu potencoi se ky program, gjithashtu, mbështet Ministrinë e Drejtësisë në ndërtimin e profesionalizimit të sistemit të përmbartimit privat, sigurimit që ligjet në fushën e të drejtës komerciale janë të harmonizuara dhe në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe praktikën më të mira ndërkombëtare duke mundësuar që të ketë zbatueshmëri më të mire të marrëveshjeve komerciale dhe kontesteve të ndërlidhura ku do të promovohen edhe zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve përmes mekanizmave të arbitrazhit dhe ndërmjetësimin. Në këtë takim palët u dakorduan për koordinim të aktiviteteve dhe bashkëpunim të mëtutjeshëm deri në përmbushjen e këtyre objektivave.

## Kërkohet harmonizimi mes Ligjit për Sponzorizime dhe Legjislacionit Tatimor



11.10.2019, **Prishtinë** - Ligji për sponzorizime ka hapur etapë të re shpresdhënëse për fuqizimin e sportit në Kosovë, njëkohësisht i ka hapur mundësinë bizneseve të investojnë në kultivimin e vlerave në sport, duke përfshirë këtu

edhe sektorin bankar, i cili në vazhdimësi ka shprehur gatishmërinë për të dhënë kontribut të drejtpërdrejt në shoqërinë kosovare. Kështu u tha sot në punëtorinë për Ligjin për Sponzorizime, e cila u organizua nga Shoqata e Bankave të Kosovës në bashkëpunim me Deloitte. Kjo punëtori përpos që trajtoj format dhe kriteret e përgjithshme të sponzorizuesve dhe përfituesve, njëkohësisht mundësoi që të sqarohen dilemat mbi evidentimin, formën e raportimit dhe sanksionet që dalin përmes këtij ligji duke përfshirë këtu trajtimin tatimor të sponzorizimit. Në kuadër të kësaj punëtorie, ku të ftuar ishin përf-

aqësues nga: Administrata Tatimore e Kosovës, Ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sportit, BQK, Komiteti Ligjor i SHBK-së, Komiteti i Financave i SHBK-së dhe Komiteti i Marketingut i SHBK-së, u potencua nevoja e krijimit të një udhëzimi administrativ dhe ri-amandamentimit të ligjit për sponzorizime i cili do të trajtonte dhe definonte qartë zbrastirat ligjore të cilat janë evidentuar pas miratimit të këtij ligji e të cilat do të mundësonin implementimin e plotë në praktikë të ligjit në fjalë. Ligji për sponzorizime në fushën e Sportit, Kulturës dhe Rinisë parashihet që të ketë efekt të drejtpërdrejt në rritjen e sponzorizimeve nga ana e sektorit privat, duke përfshirë këtu edhe sektorin bankar, i cili vazhdon të jep kontribut në ngritjen e kapaciteteve dhe avancimin e klubeve sportive në Kosovë.

## Shoqata e Bankave të Kosovës shënon Ditën Botërore të Kursimeve 2019



30.10.2019, **Prishtinë** - Nën moton “Kursimi për fëmijët sot, është një dhuratë e mrekullueshme për të nesërmen e tyre!”, sot Shoqata e Bankave të Kosovës organizoi aktivitete të ndryshme edukativo-arsimore me nxënësit e Shkollës Filllore Naim Frashëri në krye me Zëvendës-Drejtoreshën Znj. Drita Qorolli

dhe nxënësit e Shkollës Filllore Qamil Batalli, me Drejtor Z. Liridon Maliqi, duke shënuar kështu Ditën Botërore të Kursimeve, e cila organizohet nga institucionet financiare në mbarë botën. Përmes këtyre aktiviteteve, Kryeshefi Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Z. Petrit Balija përcolli me-

sazhin e sektorit bankar të Kosovës tek nxënësit rreth rëndësisë së kursimit dhe dobive që sjellë kursimi si shprehje poqëse praktikohet që nga mosha e hershme ndërkaq i njoftoj ata se edhe bankat, me qëllim që t’u ndihmojnë fëmijëve për të kursyer, kanë mundësuar që të hapen xhirrollogari bankare për fëmijë pa pagesë përmes prindërve të tyre, në mënyrë që kur të rriten të mund t’i shfrytëzojnë mjetet e grumbulluara për nevoja të arsimimit të mëtutjeshëm apo edhe për nevoja tjera personale. Nxënësve të klasave të katërta në këto shkolla ju ndanë pako me materiale edukative si dhe arka për kursime. Ky organizim u mbështet nga bankat komerciale të Kosovës, të cilat janë njëherazi anëtare të Shoqatës së Bankave të Kosovës. Kjo datë u vendos si ditë botërore e kursimeve në kongresin e mbajtur në Milano, pas luftës së parë botërore me qëllim të ngritjes së njohurive dhe rëndësisë së kursimeve. Në Kosovë, dita Botërore e Kursimeve ka filluar të shënohet nga Shoqata e Bankave të Kosovës që nga viti 2014.





## Banka TEB shënon Ditën Botërore të Mjedisit: 1 fidan i mbjellur për çdo kredi të gjelbër

Banka TEB, si partner i Bankës Evropiane për rindërtim dhe zhvillim (BERZH) në kuadër të implementimit të Kredisë së gjelbër, sot ka mbjellur 210 fidane në katër qytete të ndryshme për ta shënuar 5 Qershorin - Ditën Botërore të Mjedisit.



Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, Banka TEB në bashkëpunim me BERZH dhe klientët e vet ka mbjellur 210 fidane në Prishtinë, Prizren, Pejë dhe Malishevë. Në

aktivitetin kryesor i cili u mbajt në Prishtinë pjesëmarrës ishin drejtues të bankës, përfaqësues nga BERZH, GIEFF, Komuna e Prishtinës dhe të Bashkimit Evropian, si donatori kryesor i granteve për programin GIEFF. Secili fidan mban emrin e personit i cili ka marrë Kredi të Gjelbër në TEB dhe kështu ka ndihmuar në ruajtjen e mjedisit jetësor. Komunitat përkatëse kanë bërë të mundur sigurimin e hapësirave të nevojshme për fidanet, kurse Banka TEB jua ka bërë dhuratë fidanet klientëve të saj. Me shpresë që këto fidane të shtohen në të ardhmen dhe secili nga ne do të ndihmojë në reduktimin e ndotjes së ajrit. Banka TEB si partner i

BERZH ofron financim për investime në produkte me eficiencë të lartë të energjisë për sektorin rezidencial me grant nga BE deri në 20% të vlerës së kredisë të pranueshme për investime. Dita botërore e Mjedisit është dita e Kombeve të Bashkuara për inkurajimin e ndërgjegjësimit dhe veprimit në mbarë botën për ta mbrojtur mjedisin tonë. Tema e këtij viti i kushtohet ndotjes së ajrit. Çdo familje mund të kontribuojë në këtë sfida mbarëbotërore duke konsumuar energji në mënyrë efikase. Duke aplikuar për Kredi të Gjelbër në Bankën TEB, për teknologji eficiente ndaj energjisë, siç janë dritaret dhe dyert eficiente, sistemet e ngrohjes / ftohjes dhe sistemet e izolimit, familjet mund të ulin ndjeshëm konsumin e tyre të energjisë, dhe në këtë mënyrë do t'i ulin edhe faturat e energjisë. TEB Bankë për një botë në lëvizje.



## NLB Banka mbështet Turnirin e Basketbollit në Karroca



Më 5 Tetor, në Palestrën Sportive 'Bashkim Selishta' në Gjiilan u organizua turniri i Basketbollit në Karroçë, ku pjesëmarrëse ishin disa ekipe nga Kosova. Ky turnir u organizua nga Handikos dhe u mbështet financiarisht nga NLB Banka. Organizimi i turnirëve të tillë ka ndikim pozitiv tek vetë personat me nevoja të

veçanta dhe ofron mundësinë e socializimit dhe për shprehje të kapaciteteve dhe talenteve. Përmes këtij aktiviteti fizik si dhe ndjesisë së përkatësisë së grupit / shoqërisë, ky turnir ka ndikim të madh edhe në vetëdijesimin e shoqërisë në përgjithësi. Kontributi i NLB Bankës do të vazhdojë edhe në të ardhmen në mbështetje të aktiviteteve dhe projekteve të rëndësishme për përmirësimin e jetës së përditshme në komunitetin ku veprojmë.

## ProCredit Bank mbështet Festivalin Ndërkombëtar të Teknologjisë KOSICT



Banka ProCredit me krenari njofton se mbështet festivalin ndërkombëtar të teknologjisë KOSICT, organizuar nga Shoqata e IT-ve të Kosovës (STIKK). Mbështetja e kësaj iniciative thëllon tutje rolin e bankës ProCredit në përkrahjen e zhvillimeve të teknologjike dhe inovacionit.

## Raiffeisen Bank përkrahë aktivitetin e “Autostrada Biennale”



Autostrada Biennale me përkrahje të Raiffeisen Bank organizoj aktivitete me fëmijë në kuadër të programit të edukimit me temën “Edukimi mbi hapësirat e gjelbërta dhe shëndetin!”.

Aktivitetet kishin për qëllim që fëmijët të eksplorojnë qytetin, të reflektojnë për hapësirat e gjelbërta, lumin dhe mënyrat se si mund të kemi një mjedis të pastërt dhe të shëndoshë.

Fëmijët me moton “Revolucioni Jam Unë”, së bashku me grupin kreativ të komuni-

tetit të grave Orkide kanë realizuar një punëtori me c’rast ata u njoftuan me punë dore dhe mënyra kreative të qëndisjes së drurit me qëllim të mbrojtjes nga dëmtimi i vazhdueshëm i vendosjes së posterëve dhe reklamave të ndryshme. Fëmijët gjatë punëtorisë mësuan të qëndisin dhe përmes artit të kontribuojnë në mbrojtje të mjedisit. Pas punëtorisë fëmijët realizuan performancën e qëndisjes së drunjëve së bashku me grupin Orkide.

Programi i edukimit joformal i Autostrada Biennale përpiket të edukojë gjeneratat e reja në frymën e artit bashkëkohor përmes nxitjes së mendimit kritik duke u mbështetur në parimin e gjithëpërfshirjes. Autostrada Biennale falënderon shkollën “Lidhja e Prizrenit” për pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm në aktivitetet e saj.



## Banka Ekonomike mbështet organizimin e Streetball 3x3 Prishtina

Sporti inkurajon zhvillimin e vlerave të rëndësishme siç janë lojaliteti, këmbëngulësia, miqësia, kolegialiteti dhe solidariteti. Sporti përveç ndikimit në shëndetin fizik, ka ndikim edhe në shëndetin mendor. Sipas shumë mendimtarëve, sporti ka ndikim vendimtar në krijimin e karakterit të një shoqërie. Andaj duke i pasur këto parasys, Banka Ekonomike vazhdon të përkrah sportin, kështu duke mbështetur organizimin e Streetball 3x3 Prishtina, të cilët edhe këtë vit janë licensuar nga FIBA. Ky organizim është mbajtur për hir të çlirimit të Prishtinës, si një nga 20 aktivitetet kryesore për nder të kësaj dite, ku pati pjesëmarrës nga e gjithë bota me ekipe me renome si ajo nga Chicago, Amerika, si dhe ekipe të tjera të njohura europiane. Banka Ekonomike do të vazhdojë të kontribuoj në ngritjen e përgjegjësisë në shoqërinë tonë dhe zhvillimit të përgjithshëm profesional dhe shoqëror.

## Banka për Biznes marrëveshje bashkëpunimi për financimin e klubit basketbollistik “Sigal Prishtina”



Banka për Biznes dhe Klubi Basketbollistik “Sigal Prishtina” kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për financimin e klubit nga kryeqyteti. Arton Celina nga Banka për Biznes ka thënë se kjo marrëveshje me Prishtinën është një vjeçare, por që shpreson që të zgjatet edhe për një vit tjetër.

“Sporti ka dëshmuar që është ambasadori më i mirë në botë. KB Prishtina meriton që të jetë në pedestalin me të lartë dhe ne po mundohemi që të jemi një përkrahje për Prishtinën. Edhe Ligji për Sponsorizim është një shtytje për ne si bankë që t’i vazhdojmë mbështetjet për klube. Marrëveshja është një vjeçare dhe kjo mund të vazhdojë edhe më tutje. Unë besoj se kjo marrëveshje mund të zgjasë edhe për më shumë”, ka thënë ai. Kryetari i KB “Sigal Prishtina”, Shkelzen Fetiu, është ndarë i kënaqur me këtë marrëveshje. Ai u ka uruar mirëseardhje siç ka thënë ai në shtëpinë e kampionëve. “Ju dëshiroj mirëseardhje në shtëpinë e kampionëve dhe shpresojmë që edhe ju si bankë vendore të jeni kampion bankarë siç jemi ne”, ka thënë Fetiu


# PUBLIKIMET E SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS

“The Kosovo Banker” është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Revista botohet dy herë në vit dhe ka për qëllim të informojë publikun lidhur me industrinë bankare në Republikën e Kosovës. Për më tepër informata, drejtohuni tek web faqja e Shoqatës së Bankave të Kosovës [www.bankassoc-kos.com](http://www.bankassoc-kos.com)



[www.bankassoc-kos.com](http://www.bankassoc-kos.com)





## QENDRA E TRAJNIMEVE NË SHOQATËN E BANKAVE TË KOSOVËS

Organizon trajnime të ndryshme për sektorin financiar të Kosovës duke përfshirë edhe këto fusha:

- > Menaxhimi rrezikut bankar
- > Pajtueshmëri dhe Parandalimin e Pastrimit të Parave
- > Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
- > Auditim dhe kontroll i brendshëm
- > Menaxhimi i Aseteve dhe Detyrimeve
- > Bankingu Digjital
- > Menaxhimi i sigurisë kibernetike dhe i informacionit
- > Vlerësimi i kredisë
- > Shitja e shërbimeve financiare
- > Financimi i tregtisë
- > Mbrojtja e të dhënave personale
- > Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- > Udhëheqje dhe menaxhim

### PARTNERËT:



Qendra për trajnime bankare në kuadër programit të saj të trajnimeve ofron edhe certifikime të njohura ndërkombëtare, uebinare dhe trajnime përmes kanaleve elektronike në fushën e industrisë bankare.



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Shoqata e Bankave të Kosovës  
është anëtare e Rrjetit Evropian  
për Trajnime Bankare (EBTN)

